

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7701 E martë 6 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Një ndër argumentet kryesore që është përdorur kundër dialogut teknik të deritanishëm me Serbinë dhe që po përdoret edhe sot kundër fazës finale ...
Vijon në faqet 20-21

Nga ADRI NURELLARI

Dialogu me Serbinë dhe nevoja për t'i mbajtur negociatat sekrete



Opinion **i** Ditës

Nuk ka dyshim se Ilir Meta ka marrë jo vetëm një vendim të paprecedent, por edhe shumë të debatushëm, duke vendosur të mos i dekretojë ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

Dashnorët e rremë të Kushtetutës



Debati për platformat në grupin e punës
Akademia e Shkencave, Gjinushi dhe Fuga, dy orë përplasje me tone të larta për reformat

Fuga: Platforma juaj kalbëzon Akademinë.
Gjinushi: Reforma e Fugës, rikthim në 2007

FATMIRA NIKOLLI

A është rikthyer pas një viti përplasjes mes qeverisë dhe akademikëve reforma në pikën zero? Sot Akademia e Shkencave nuk ka kryetar, menaxhohet nga sekretari shkencor, ndërsa prej shtatorit të 2017-ës, kryeministri ...
Në faqen 18

THELLOHET KRIZA/ EDI RAMA: NUK NA DIKTON ASKUSH, S'MBARON ME KAQ

LLESHI ZV.MINISTER, META: S'KA ME SEKRETAR TË PARË

Kuvendi mbledhet sot për shkarkimin e Xhafajt, ish-ministri i Brendshëm: Shantazh nga një pjesë e politikës. Audiopërgjimi, manipulim kriminal



(Në foto) Kryeministri Edi Rama dhe Presidenti Ilir Meta

PROPOZIMI I METES

Vitore Tusha, gjyqtarja që la në burg Fatos Nanon, në krye të KLSH-së

Në faqen 5

PROJEKTI

Sheshi 'Shqiponja' me 3 nivele kalimi, tek 'Astiri' do të ndërtohet nënkallim

Në faqet 8-9

FLET MODERATORJA

Rrëfëhet Roza Lati:

Ja pse u putha me Feron, jam rritur në skenë me mamin

Në faqen 12

"12 MILJET"

Përplasja për kufirin, Erdogan, Greqisë: S'lejojmë banditët e detit

Në faqen 17

ISH-PRESIDENTI



Meidani: Emërimi i ministrave zgjidhet me konsulta paraprake president-kryeministër

Në faqen 4

Policia arreston 30-vjeçarin nga Burreli: Dyshohet si 'killer me pagesë'

Atentati ndaj Emiliano Boçi, pranga vrasësit

Precedenti, i arrestuari Hektor Xheçuka u kap për plagosje në 2015

Një 30-vjeçar nga Burreli është arrestuar dje nga policia e Tiranës, pasi dyshohet të jetë autor i vrasjes së Emiliano Boçi. Ngjarje kjo e ndodhur më 14 janar të këtij viti në Tiranë. Bëhet fjalë Tori (Hektor) Xheçuka, i cili u kap nga policia e kryeqytetit në bashkëpunim me proku-



rorinë. Identifikimi i autorit të dyshuar u bë pas një hetimi disamujor me metoda speciale të hetimit nga Seksioni për Krimet e Rënda në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kapet dhe vihet ...

Në faqen 6

DEKRETI NGERÇI

Presidenti: Nuk do të lejoj asnjë përpjekje sfiduese ndaj autoritetit të Presidentit

'Lleshi', Meta: Iku koha kur shteti drejtohej me sekretar partie

"Gati të japë sot shpjegime para Kuvendit"

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta është i prerë në qën drimin e tij se nuk do të lejojë asnjë përpjekje sfiduese ndaj autoritetit të institucionit që përfaqëson si kryetar i shtetit. Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Zëdhënësi i Presidentit të Republikës, Tedi Blushi, i pyetur dje nga mediat lidhur me takimin e së dielës Rama-Meta theksoi se "informacioni i dhënë nga Kryeministria lidhur me takimin ka qenë ezaurues". "Informacioni i dhënë nga Kryeministria lidhur me takimin ka qenë ezaurues. Presidenti Meta konfirmon përkushtimin e tij maksimal në respekt të Kushtetutës, për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet në vend, në interes të stabilitetit, forcimit të institucioneve dhe rritjes të kulturës së bashkëpunimit ndër-institucional me transparencë dhe konstruktivitet. Por njëkohësisht, Presidenti i Republikës bën të qartë se nuk do të lejojë asnjë përpjekje sfiduese ndaj autoritetit të institucionit që përfaqëson si Kryetar i Shtetit, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Presidenti Meta ka bindjen e plotë se koha e drejtimit të shtetit shqiptar me sekretar të Parë ka përfunduar njëherë e përgjithmonë", theksoi z.Blushi. Dy ditë më parë, Kryeministria theksoi se "me kërkesë të tij, kryeministri u takua me Presidentin e Republikës, për të diskutuar rreth përmbytjes së letërës së këtij të fundit mbi propozimin për dekretimin e Gjeneral Sandër Lleshit si ministër i Brendshëm. Bashkëbisedimi ishte i hapur e konstruktiv dhe kryeministri do të vijojë komunikimin me Presidentin e Republikës".



Presidenti Ilir Meta

DEKLARATA

"Presidenti i Republikës ka shprehur gjithmonë gatishmërinë e tij të japë shpjegime në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për të gjitha çështjet që Kuvendi do të shprehë interes. Presidenti Meta ka bindjen e plotë se koha e drejtimit të shtetit shqiptar me sekretar të parë ka përfunduar njëherë e përgjithmonë" - tha zëdhënësi i Presidentit, Tedi Blushi.

"Rama kërkon të kontrollojë krimin"

Emërimi, PD: Lleshi, i papërshtatshëm në Ministrinë e Brendshme

Për demokratët këm bëngulja e kryeministrit për emërimin e Sandër Lleshit në drejtimin e Ministrisë së Brendshme, konfirmon qëndrimin e opozitës së Edi Rama e ka jetike kontrollin e këtij dikasteri. Përmes një deklarate për mediat opozita deklaroi dje se duke qenë vetë de facto Ministër i Brendshëm, kryeministri ka më shumë mjete për të mbrojtur Olsi Ramën, Vangjush Dakon, Taulant Ballën, Damian Gjinkurin, Arben Ahmetaj dhe këdo tjetër anëtar të bandës së tij në pushtet. Emërimi i Lleshit sipas PD-së provon që Edi Ramës nuk i intereson lufta kundër kriminit të organizuar, por mbrojtja e tij me çdo çmim, prandaj i duhet një kukull si Sandër



Lleshi për të mbrojtur veten dhe për t'i siguruar paprekshmëri kriminit. "Emërimi i figurës më të papërshtatshme për të drejtuar Ministrinë e Brendshme provon që Edi Ramës nuk i intereson lufta kundër kriminit të organizuar, por mbrojtja e tij me çdo çmim, prandaj i duhet një kukull si Sandër

SHPJEGIMI

Kuvendi mblidhet sot në seancë parlamentare ndërkohë që zëdhënësi i presidentit, Tedi Blushi sqaroi dje se z.Meta është gati t'i japë shpjegime nëse Kuvendi është i interesuar. "Presidenti i

Republikës ka shprehur gjithmonë gatishmërinë e tij t'i japë shpjegime në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për të gjitha çështjet që Kuvendi do të shprehë interes", thek-

AKUZA

Për demokratët "Edi Rama nuk mund ta luftojë Edi Ramën, prandaj i duhet një kukull si Sandër Lleshi për të mbrojtur veten dhe për t'i siguruar paprekshmëri kriminit", thuhet në reagimin e PD-së.

trisë së Brendshme nuk e ka luftuar krimin e organizuar, por ka bashkëpunuar dhe e ka mbrojtur atë me porosi direkte të Edi Ramës. Edi Rama nuk mund ta luftojë Edi Ramën, prandaj i duhet një kukull si Sandër Lleshi për të mbrojtur veten dhe për t'i siguruar paprekshmëri kriminit", thuhet në reagimin e PD-së.

soi zëdhënësi i Presidentit Ilir Meta. Sot është caktuar të mblidhet jashtë radhe seanca parlamentare për të votuar dekretimin e presidentit për shkarkimin e Fatmir Xhafaj nga posti i ministrit të Brendshëm. Mësohet se



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

Ish-ministri i Brendshëm: Lleshi, pa personalitet

Deputeti demokrat, ish-ministri i Brendshëm Flamur Noka komentoi dje në News24 zhvillimet e fundit duke u ndalur fillimisht tek mosdekretimi i Sandër Lleshit si ministër i Brendshëm. Noka hodhi akuza të rënda ndaj qeverisë, ndërsa duke iu referuar daljes së parë në media të Lleshit tha se ishte zhgënjyese dhe u tregua një njeri pa karakter. "Është në funksionin kushtetues të presidentit ta dekretojë apo mos ta dekretojë. Presidenti i Republikës është garant i Kushtetutës dhe unitetit kombëtar. Lleshi u paraqiti si një njeri që e adhuronte Ramën, u tregua një njeri pa personalitet. Çfarë tregon se Rama ka një nxitim të madh për të zëvendësuar Xhafajn. Rama kërkon të jetë vetë dhe ministër i Brendshëm. Pamë një kandidaturë për ministër pa personalitet, çka hap rrugë qartësisht për të menduar se Rama do të jetë vetë ministër. Prezantimi atë natë ishte tmerrësisht zhgënjyese, tregonte që Rama kërkon të vërë në krye të Ministrisë së Brendshme që ta drejtojë vetë", deklaroi deputeti i PD.

Krimi elektoral, PD: Dako duhet të arrestohet

Partia Demokratike kërkoi sërisht dje arrestimin e kreut të Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako për krim elektoral të blerjes së votave përmes bandave. Në një dalje për mediat, kryetarit të grupit të deputetëve demokratë, Edmond Spaho tha se Vangjush Dako duhet të arrestohet pa vonesë për krimin elektoral të blerjes së votave nëpërmjet bandave. "Cdo ditë në liri, ai shkatërron prova dhe manipulon dëshmitarët, i ndihmuar plotësisht nga kryeministri i vendit Edi Rama. Mosarrestimi i Dakos është prova e shkatërrimit total të Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe hedh në erë alibitë qesharake për suksesin e reformës në drejtësi", u shpreh z.Spaho. Ai përmendi se: "Përgjimet e dosjes 339 kanë faktuar se Vangjush Dako është në komunikim të vazhdueshëm me bandat para, gjatë dhe pas zgjedhjeve, duke shkëmbyer me pasuri dhe pushtet votat e blera për tepsinë e Edi Ramës. Faktet e kriminit elektoral të Vangjush Dakos janë të qarta dhe për këtë krim ai duhet të jetë në burg!"

kryeministri Rama nuk do të çojë një emër tjetër në Presidencë, por në tryezën e Metës do të vijojë të jetë emri i Sandër Lleshit, deri kur kreu i shtetit të krijojë bindjen për dekretimin e tij. Ndërkohë grupi parlamentar i PS ven-

dosi dje që Sandër Lleshi do emërohet zëvendësmministër i Brendshëm, dhe do t'i delegohen kompetencat e ministrit të Brendshëm. Emërimi i Sandër Lleshit në postin e zv/ministrit do të bëhet me një vendim qeverie.



Thellohet kriza Presidencë-mazhorancë, PS vendos të qeverisë me zv.ministër

Rama shmang Metën, emëron Lleshin në Ministrinë e Brendshme

"Ne nuk na dikton askush, por nuk mbaron me kaq"

Të dielën në mesditë kryeministri Edi Rama zbriti shkallët e Presidencës, teksa te dera e përcoill një nga zyrtarët e këtij institucioni dhe jo vetë kreu i shtetit, Ilir Meta, me të cilin kishte biseduar për afro 90 minuta për vendimin e mosdekretimeve të Sandër Lleshit si ministër i Brendshëm. Një shenjë e qartë kjo se pavarësisht mesazhit inkurajues të shpërndarë jo zyrtarisht nga Kryeministria se, "bashkëbisedimi ishte i hapur e konstruktiv", gjërat nuk kishin shkuar në drejtimin e duhur dhe se dy kërret e lartë të shtetit nuk kishin gjetur gjuhën për t'i dhënë zgjidhje ngërçit të krijuar. Menjëherë pas këtij takimi, Rama mbodhi në Kryeministri të tijtë dhe vendosi që të pranonte sfidën që i kishte bërë presidenti dhe t'i përgjigjej atij me lëvizjen e tij në "shahun" politik. Sandër Lleshi emërohet në krye të Ministrisë së Brendshme jo si ministër, por si zëvendësministër. Një precedent që e kishin praktikuar më parë edhe Fatos Nano në vitin 2003.

VENDIMI
Vendimin ai ua bëri publik dje paradite edhe deputetëve gjatë mbledhjes së grupit parlamentar, ndërsa siç bëri të ditur, mori prej tyre mbështetjen e plotë për këtë zgjidhje. Vetë nëpërmjet një mesazhi në rrjetet sociale bëri publik vendimin për të emëruar në krye të Ministrisë së Brendshme Sandër Lleshin, ndërsa paralajmëroi se çështja nuk mbaron me kaq, por se qëndrimet e tjera do t'i bënte publike vetëm sot, gjatë seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Shqipërisë, ku do të votohet edhe dekreti për largimin e Fatmir Xhafajt si ministër i Brendshëm. "Dakordësi e plotë në grupin parlamentar. Kuvendi do të miratojë mesazhin e presidentit për shkarkimin e ish-ministrit të Brendshëm. Sandër Lleshi do të marrë drejtimin e MB si zëvendësministër", shkroi kryeministri. Por përveçzyrtarizimit të Lleshit në krye të Ministrisë së Brendshme, duket se ai paralajmëron me anë të këtij mesazhi se lëvizja e tij në lojën e shahut politik nuk mbaron me kaq. "Por nuk mbaron me kaq. Për më shumë do t'i drejtohem Kuvendit nesër në 10.00", mbyllte mesazhin e tij kryeministri. Ndaj, përveç konfliktit të hapur me Presidentin, ajo që mbetet për t'u qartësuar sot e ditët në vijim është pikërisht



Mbledhje grupit parlamentar të PS-së

MESAZHI
"Dakordësi e plotë në grupin parlamentar. Kuvendi do të miratojë mesazhin e presidentit për shkarkimin e ish-ministrit të Brendshëm. Sandër Lleshi do të marrë drejtimin e MB-së si zëvendësministër, por nuk mbaron me kaq. Për më shumë do t'i drejtohem Kuvendit nesër në 10.00".

SHKURTE

Qeverisja me zëvendësministër, Nano vendosi precedentin e parë

Emërimi i Sandër Lleshit si zëvendësministër i Brendshëm me kompetencat e ministrit nuk përbën precedentin e parë në Shqipëri. Para Ramës, një zgjidhje të tillë e ka aplikuar edhe paraardhësi i tij në krye të PS-së, Fatos Nano. Bëhet fjalë për konfliktin politik të vitit 2003, ku sërisht protagonist i bllokimit të miratimit të disa ministrave përfshi edhe atë të Brendshmin ishte sërisht Ilir Meta. Në atë kohë, Nano nuk mundi të sigurojë votat për kalimin e dekretit për emërimin e Iglit Toskës në postin e ministrit të Brendshëm dhe të Marko Bellos në postin e ministrit të Jashtëm. Kjo, për shkak se deputetët mbështetës të Metës nuk pranuan të miratojnë ndryshimet e propozuara nga Nano. Për rrjedhojë, ish-kryeministri Fatos Nano vendosi të qeverisë për disa kohë me zëvendësministrat, duke i dhënë Iglit Toskës kompetencat e plota për drejtuar Ministrinë e Brendshme pas largimit në atë kohë të Luan Ramës. E njëjta situatë ndodhi edhe tek Ministria e Integritimit, ku Sokol Nako dha dorëheqjen dhe Nano propozoi Ermelinda Meksini si zëvendësministër. Kriza do të zgjaste pak muaj dhe në fund të atij viti Nano do të plotësonte kabinetin e tij pas zgjedhjeve në parti.

Sot, seanca e jashtëzakonshme për shkarkimin e Xhafajt

Kuvendi do të mbledhet sot në seancë të jashtëzakonshme për të miratuar dekretin e Presidentit të Republikës, Ilir Meta, për shkarkimin Fatmir Xhafajt nga detyra e ministrit të Brendshëm. Kuvendi ka publikuar dje njoftimin zyrtar, ku bën të ditur thirrjen e kësaj seance jashtë radhe. "Bazuar në nenin 98 të Kushtetutës, ku parashikohet se 'Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të kryeministrit brenda 7 ditëve. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi", ditën e martë, më datë 6.11.2018, në orën 10.00, Kuvendi do të mbledhet në seancë plenare për shqyrtimin e dekretit nr. 10922, datë 27.10.2018 "Për shkarkimin të ministrit të Brendshëm", thuhet në njoftimin e Kuvendit. Në fakt, thirrja e mbledhjes së sotme është e detyrueshme nga ana e Kuvendit për shkak të afatit kohor, që përcakton Kushtetuta për miratimin e dekretit të presidentit. Ajo i lë atij vetëm 10 ditë kohë dhe e marta e sotme është afati i fundit.

Xhafaj: Më shantazoi PD me disa institucione ligjzbatuese

Ministri në ikje përshëndet zgjedhjen e Lleshit

Ministri i Brendshëm në largim, Fatmir Xhafaj ka përcjellë dje edhe mesazhin e fundit në këtë cilësi, duke përshëndetur punën e policisë të bërë në dy muajt e fundit, ndërsa bëri të ditur se ishte shantazuar nga opozita në bashkëpunim me segmente të tjera të autoriteteve ligjzbatuese shqiptare. "Ndjej keqardhje për atë pjesë të politikës shqiptare, e cila në debatin për mua si person, apo në diskutimet mbi Policinë e Shtetit, është sjellë, pak të thuash diletante dhe e papërgjegjshme. Duke përfshirë këtu edhe manipulimin komplet kriminal të bërë në çështjen e audiopërgjimit me një qëllim final: shantazhin ndaj meje në funksionin e ministrit. E për fat të keq në këtë orkestrim duket se janë përfshirë edhe segmente të disa agjencive ligjzbatuese vendëse. Dua të nënvizoj edhe faktin se



ky sulm jo vetëm ka në themel diletantizmin politik të opozitës, por ai edhe për këtë shkak, ka pas tij interesat e botës së kriminit", tha Xhafaj. Lidhur me dorëheqjen nga kreu i Ministrisë së Brendshme, Xhafaj shtoi se ishte një vendim i marrë pasi përmbushi objektivat në këtë post. "Po largohem nga kjo detyrë, rrjedhojë e një vendimi të paimponuar nga ndonjë rrethanë objektive, apo subjektive, por si një vendim i marrë besoj

SHANTAZHI
"Për fat të keq, në këtë orkestrim duket se janë përfshirë edhe segmente të disa agjencive ligjzbatuese vendëse. Dua të nënvizoj edhe faktin se ky sulm jo vetëm ka në themel diletantizmin politik të opozitës, por ai edhe për këtë shkak, ka pas tij interesat e botës së kriminit". në kohën e duhur, pasi përmbusha, besoj, më së miri objektivat kryesorë që i vura vetes në ditën kur vendosa ta pranoja dhe ripranoja këtë sfidë". Ai përcolli një mesazh edhe për Sandër Lleshin, emrin e propozuar nga kryeministri Edi Rama për ta zëvendësuar në postin e ministrit të Brendshëm. "Ai është tashmë në bordin e një treni të nisur, tren i cili uroj të ecë edhe me shumë shpejtësi", u shpreh Xhafaj.

mesazhi që përcjell Rama dhe se cila do jetë lëvizja e tij e radhës për të zënë "mat" presidentin. **GRUPI**
Gjithsesi, ai gjatë mbledhjes së grupit bëri të qartë se kreu i shtetit ka shkelur Kushtetutën, por pa bërë të ditur se cilat do të ishin hapat që do të ndërmerreshin mazhoranca për zhbërë këtë antikushtetutshmëri. "Zgjidhje të arsyeshme. Nuk kemi për konflikt me presidentin, edhe pse vendimi i presidentit është një ftesë për

konflikt, me apo pa dashje. Ne nuk e duam. Ne kemi detyrë të ezaurojmë çdo mundësi, por nuk do të gëndrojmë në pozitë të diktuar. Emërimi në krye të zëvendësministrit është fillimi i procesit, jo fundi. Nesër do të fillojmë t'i krijojmë presidentit bindjen se është hapi i parë. Nesër në seancë do të miratojmë dekretin për shkarkimin e Xhafajt dhe pas seancës do bëjmë emërimin e Sandër Lleshit si zëvendësministër", mësohet të jetë shprehur Rama para

deputetëve. Më tej, ai ka inkurajuar të zgjedhurit e vet se mazhoranca është solide dhe nuk mund t'i imponohet askush. "Ne nuk na dikton askush, jemi shumica, kemi mandat për të udhëhequr Shqipërinë, por s'duam konflikt. Ne do rrimë në binarët e Kushtetutës, na takon ta mbrojmë atë. Mungesa e Gjykatës Kushtetuese na krijon problem, por parlamentin është sovran, merr vendimet e veta", mësohet të jetë shprehur Rama.

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARIMORE GJYQËSORE SUELA METHOXHA
 Dt. 05.11.2018 ora 16:00
 Përfundon Ankandi i Dytë për pasuritë:
 - Pasuria "Lokal nr.4" me sip.66 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.
 Me çmim 46 200 Euro
 - Pasuria "Lokal nr.5" me sip.43 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.
 Me çmim 36 120 Euro
 - Pasuria "Lokal nr.6" me sip.110 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.
 Me çmim 98 560 Euro
 Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr. L.11, Biv.kryesor (ish kinma Iliria), Kati-2, Durrës, Kontakti Cel 0682096575

DEKRETI PËRPLASJA

Ish-presidenti: Ngërçi zgjidhet me konsulta paraprake kryeministër-president

Meidani: Mosbashkëpunimi solli krizën mes Ramës e Metës

"Si i shmanga problemet gjatë presidencës sime"

Ish-Presidenti socialist, Rexhep Meidani gjatë viteve 1997-2002 ia lë fajin mungesës së dialogut mes dy krerëve të shtetit krizën politike dhe institucionale që është krijuar së fundmi nga mosdekretimi i ministrit të ri të Brendshëm. Për "Gazeta Shqiptare" ai ka komentuar zhvillimet e fundit politike në vend dhe në mënyrë të veçantë konfliktin e krijuar mes presidentit dhe kryeministrit, duke theksuar se ngërçi ka ardhur si pasojë e mungesës së diskutimeve paraprake mes tyre. Ai u shpreh se gjatë presidencës së tij procedohej ndryshe nga tani, ku kryeministri para se të bënte një propozim konkret, siç është edhe rasti i tanishëm, diskutonte paraprakisht me presidentin. Kjo mënyrë thekson Meidani arrinte që të shmangte konflikte apo kriza të tilla. "Praktika e mëparshme edhe gjatë kohës që unë isha në Presidencë ka qenë që bashkëbisedohej përpara se të niseshin letrat zyrtarisht. Pra, bashkëbisedohej mes presidentit dhe kryeministrit paraprakisht për të shprehur mosmarrëveshjet që mund të kishin dhe pastaj procedohej me propozim".



Ish-Presidenti socialist, Rexhep Meidani

problem e ka po me Metën, por kësaj herë në pozicionin e kreut të shtetit. 10 ditë më parë kryeministri pasi kishte pranuar dorëheqjen e Fatmir Xhafajt si ministër i Brendshëm, i çoi menjëherë Presidentit të Republikës emrin e Sandër Lleshit si zëvendësues të tij. Por

ndërsa propozimin për shkarkimin e Xhafajt, Meta e firmosi menjëherë, atë për emërimin e Lleshit e la pezull. Ai shfrytëzoi gjithë afatit 7 ditor që i lejon Kushtetuta për të shpallur për herë të parë në historinë e Presidencës shqiptare, mosdekretimin e një ministri.



Shkarkimi i Metës? Peza: Nuk mund të paragjykohet asnjë hap

Andërsa ka komentuar zhvillimet e fundit politike dhe konfliktin mes Ramës dhe Metës ka deklaruar se presidenti bëri një akt politik, ndryshe nga sa parashikon Kushtetuta. "Presidenti i Republikës nuk mund të bëjë një akt politik nëpërmjet një dekreti për një ministër, për aq kohë sa vetë Kushtetuta e ka përcaktuar se, presidenti nuk mund të jetë anëtar i një partie politike në ushtrimin e detyrës", deklaroi Peza gjatë një interviste në Top Channel. Më tej ai sqaroi se nuk ka një nismë për shkarkimin e Metës, megjithëse kërkoi që të mos paragjykohet asnjë hap. "Nuk mund të paragjykohet asnjë hap. Qëndrimi i Partisë Socialiste, pavarësisht opinionit të gjithsecilit, është ai i shprehur publikisht nga kryeministri Rama. Në këtë udhëtim drejt një ngushtice të re të qeverisjes, ka sirenë nga të dyja krahet për çdo lloj veprimi dhe qëndrimi, qoftë edhe 'in extremis', siç mund të jetë rasti i ndërmarrjes së një hapi për shkarkimin e presidentit. Në këtë moment nuk ka një mendim dhe qëndrim të tillë", garantoj Peza.



Gjatë një seance parlamentare

PRAKTIKA

"Praktika e mëparshme edhe gjatë kohës që unë isha në Presidencë ka qenë që bashkëbisedohej përpara se të niseshin letrat zyrtarisht. Pra, bashkëbisedohej mes presidentit dhe kryeministrit paraprakisht për të shprehur mosmarrëveshjet që mund të kishin dhe pastaj procedohej me propozim".

Dekretimi i ministrave, Nishani: Kushtetuesja nuk u shpreh në 2016

"Gjykata njoftoi se nuk mund ta shqyrtonte çështjen"

Ish-presidenti Bujar Nishani në një reagim për "News24" ka sqaruar edhe njëherë kërkesën që bëri në 2016-ën pranë Gjykatës Kushtetuese, së cilës iu drejtua për interpretim të kompetencave të kreut të shtetit lidhur me dekretimin të dy ministrave Milva Ekonomit dhe Arben Ahmetaj. Duke marrë shkas nga situata e krijuar me mosdekretimin nga presidenti Meta të Sandër Lleshit si emër i propozuar nga kryeministri Edi Rama për postin e ministrit të Brendshëm, Nishani ka treguar detaje nga përgjigjia asokohe e Gjykatës Kushtetuese, e cila nuk mundi të bënte një interpretim të nenit 98 pika 1 e Kushtetutës. Sipas Nishanit Kushtetuesja njoftoi në 2016-ën se nuk mund ta shqyrtonte çështjen pasi nuk kishte një situatë konkrete. Nishani shton më



GAZETA

"Ka një korrespondencë dhe përgjigje nga Kushtetuesja që gjendet në arkivin e Presidencës. Gjykata njoftoi se nuk mund ta shqyrtonte çështjen pasi nuk ka një situatë konkrete. Dmth, ata thoshin se duhet të ishim në kushtet e mosdekretimit të ministrave.

tejt se Gjykata Kushtetuese pretendonte se "duhet të ishim në kushtet e mosdekretimit të ministrave nga presidenti pa ta konsideronin që ka një objekt dhe të vendoset të shqyrtohet". "Ka një korrespondencë dhe përgjigje nga Gjykatën Kushtetuese që gjendet në arkivin e Presidencës. Gjykata njoftoi se nuk mund ta shqyrtonte çështjen pasi nuk ka një situatë konkrete. Dmth ata thoshin se duhet të ishim në kushtet e mosdekretimit të ministrave

nga Presidenti pa ta konsideronin që ka një objekt dhe të vendoset të shqyrtohet. Pra në dhomën e këshillimit ata vendosën për të mos e kaluar në seance. Kërkesa nuk kishte fare lidhje me bërjen e dekretive për Ikonimi - Ahmetaj se ato kërkesa nuk ishin për emra konkret por kërkohej interpretim i Gjykatës Kushtetuese për ato çështjet. Ne e nisëm kërkesën pas dekretive dhe miratimit të tyre në parlament", pohoi Nishani.

Në kulmin e krizës politike dhe institucionale që ka kapur vendin, ajo që mund të jete zgjidhje situatës është Gjykata Kushtetuese. Por aktualisht ajo është tërësisht jashtë funksionit, pasi nga 9 anëtarë ajo ka vetëm 2. Mosfunksionimi i saj e tregojnë edhe shifrat, të cilat tregojnë Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka marrë vetëm një vendim në periudhën janar-mars të këtij viti për shkak të mbarimit të man-

Bllokimi i Kushtetueses, gjykata ka vetëm 2 anëtarë

datit të disa anëtarëve dhe shkarkimit të disa të tjerëve nga vetingu. Ky institucion, i mbetur me vetëm dy anëtarë, dhe i paralizuar në vendimmarrje që nga marsi i këtij viti, ka dhënë verdiktin vetëm për një nga 107 kërkesa të dorëzuara për këtë periudhë. Mungesa e 7 anëtarëve në Kushtetuese ka bërë që 48 çështje të

mbeten pezull për shkak se nuk ka quorum për të marrë vendime, madje 7 prej këtyre çështjeve janë të mbaruara që nga viti i kaluar. Një tjetër fenomen që vihet re këtë vit në krahasim me 2017, është rënia e numrit të ankesave, nga 279 në 107, duke treguar mungesën e besimit në gardianin e fundit të Kushtetutës.



NJOFTIMI

"Presidenti Meta e njohu z. Ruçi me konsultimet e zhvilluara prej tij për datën e zgjedhjeve të ardhshme lokale. Gjithashtu, Presidenti Meta i bëri me dije kryetarit Ruçi zhvillimin e procedurave transparente për të ftuar kandidatët, të cilët kanë paraqitur interesin për kreun e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me qëllim përzgjedhjen e një kandidati të përshtatshëm dhe me integritet për këtë pozicion të rëndësishëm".



Vasili sulmon Ramën: Çfarë zgjyre dhe llumi në krye të qeverisë

Kreu i grupit parlamentar i LSI-së, Petrit Vasili, sulmoi dje kryeministrin Edi Rama sipas të cilit "mërzitet" që nuk ka Gjykatë Kushtetuese për të emëruar ministrin e ri të Brendshëm "në vazhdimësinë e trafikut dhe krimit, një nga çinonvnikët e tij freskberës". "Çfarë llumi në krye të qeverisë. Për kryeministrin që të përplante teatrin s'kishte rëndësi Gjykata Kushtetuese se priste puna. Edhe për marrëveshjen e detit nuk kishte asnjë problem për kryeministrin se nuk ka Gjykatë Kushtetuese. Ndërsa për të emëruar ministër në vazhdimësinë e trafikut dhe krimit, një nga çinonvnikët e tij freskberës, kryeministri mërzitet fort se s'ka Gjykatë Kushtetuese. Po ky kryeministër që nxori njëmijë fëlliqësira nga goja për presidentin Nishani, aq sa i hoqi edhe portretin nga zyrrat, sot përmes megafonëve të lodhur i referohet idiotësisht ish-presidentit Nishanit. Çfarë zgjyre dhe llumi në krye të qeverisë...", shprehet z. Vasili.

Shoqëria permbartimore JUSTITIA

Shoqëria permbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza dyte, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna: Apartamenti me nr.pas.7/21+1-4, z.k.8360, vol.26, fq. 204, me sipërfaqe 138.40 m2, Tiranë në pronësi të Gentian Kujtim TOSKU Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 81.379 (tetëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) EUR. Ankand zhvillohet në datën 04.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartës gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 42270890

Pas konsultimeve me partitë, presidenti dekreton datën për qeverisjen e re vendore

Zgjedhjet administrative mbahen më 30 qershor 2019

Zbardhet takimi i Meta-Ruçi në Presidencë

Valentina Madani

Shqiptarët do të votojnë më 30 qershor 2019 për drejtuesit e rinj të pushtetit lokal. Presidenti Ilir Meta dekretoi dje datën 30 qershor 2019 për mbajtjen e zgjedhjeve lokale. "Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të zhvillohen ditën e diel, më datë 30 qershor 2019", tha presidenti në dekreton e tij, i cili hyn në fuqi menjëherë. Javën e kaluar, për të biseduar mbi datën e zgjedhjeve, kreu i shtetit priti në takime konsultative kryetarët e grupeve parlamentare. Presidenti duhej të vendoste për një datë për mbajtjen e zgjedhjeve lokale 9 muaj përpara mbajtjes së tyre, që në Kod përcaktohet se duhet të zhvillohen nga data 15 mars deri më 30 qershor. Pavarësisht një kërkesë të ardhur nga operatorët turistikë që të vlerësohet mundësia që zgjedhjet të mbahen në një datë që nuk dëmton sezonin turistik, siç ka ndodhur në proceset e fundit zgjedhore, kreu i shtetit vendosi për të dielën e fundit të muajit qershor. Pikërisht në funksion të datës së zgjedhjeve, Presidenti Meta priti dje në zyrën e tij kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçin. Nuk dihet se cila do të jetë përplasja e radhës mes presidentit dhe qeverisë, por gjithsesi, ajo që Meta zgjodhi të japë si mesazh për mediat ishte se komunikimi me kreun e parlamentit ishte jo vetëm institucional, siç ndodhi me kryeministrin. Përballë kamerave, ai doli personalisht të përshëndeste në ikje Ruçin deri në dalje të Presidencës, gjë që nuk e ka bërë në takimet e fundit. Presidencën njofton se: "Presidenti Meta e njohu kryetarin Ruçi me konsultimet e zhvilluara prej tij për datën e zgjedhjeve të ardhshme lokale. Gjithashtu, Presidenti Meta i bëri me dije kryetarit Ruçi zhvillimin e procedurave transparente për të ftuar kandidatët, të cilët kanë paraqitur interesin për kreun e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me qëllim përzgjedhjen e një kandidati të përshtatshëm dhe me integritet për këtë pozicion të rëndësishëm". Vendimi i kreut të shtetit erdhi pas konsultimeve të javës së shkuar me kryetarët e grupeve



Foto ilustruese

Vitore Tusha, gjyqtarja që la në burg Fatos Nanon

Presidenti propozon gjyqtaren e Kushtetueses për kreun e KLSH-së

Anëtarja e Gjykatës Kushtetuese, Vitore Tusha, është përzgjedhur prej Presidentit Ilir Meta si kandidatë për kryetare të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Vendimi është marrë pas shqyrtimit të 34 kandidatëve që u futën në garë për detyrën në të cilën Bujar Leskaj do të qëndrojë deri në dhjetor. Në njoftimin e Presidencës thuhet se pas një procesi transparent dhe objektiv, ka arritur në konkluzionin se Tusha plotëson kushtet dhe kriteret ligjore për të qenë kandidatë për të përshtatshme për të zgjedhur në krye të këtij institucioni kushtetues. Vitore Tushës i ka mbaruar mandati në Gjykatën Kushtetuese në mars të 2017-ës. "Bazuar në eksperiencën solide dhe kontributin e pandërprerë të zj. Tusha, në fushën e jurisprudencës, si në sistemin gjyqësor, ashtu dhe referuar angazhimeve të saj akademike si pedagogje në institucionet e arsimit të lartë në fushën e së drejtës, trajnuese dhe pedagogje në Shkollën e Magistraturës, apo edhe si eksperte në fushën



Detyra

Vitore Tusha është aktualisht anëtare në detyrë e Gjykatës Kushtetuese, të cilës i ka mbaruar mandati në këtë funksion që prej datës 10 mars 2017.

së drejtës kushtetuese e më gjerë", thuhet në njoftimin e Presidencës. Një tjetër pikë në të cilën është mbështetur kreu i shtetit për përzgjedhjen është mosangazhimi partiak i saj. Në vitin 1983, Vitore Tusha është emëruar përmbartuese gjyqësore në Gjykatën e Tiranës. Më pas, për disa vite ka ushtruar profesionin e avokates, si dhe të gjyqtares. Në 2008-ën, ajo është zgjedhur anëtare e Gjykatës Kushtetuese, detyrë që e ushtron deri më sot. Në nëntor të vitit 1995, Tusha rrezoi kërkesën e ish-kryeministrit Fatos Nanon, i cili kërkoi lirim të parakohshëm nga burgu, pasi ishte

dënuar me 12 vite heqje lirie. Megjithatë, Nanon e la burgun para kohe, pasi ndryshimet e atëhershme në Kodin Penal e ricilësuan veprën për të cilën ai ishte shpallur fajtor, duke ulur edhe parashikimin e dënimit. Në vitin 2009, ajo ishte pjesë e Gjykatës Kushtetuese, kur u rrezua marrëveshja e detit me Greqinë. Kreut aktual të KLSH-së, Bujar Leskaj i mbaron mandati 7-vjeçar në fund të dhjetorit dhe garës së hapur nga Presidencë për postin e kryetarit të KLSH-së, iu përgjigjën 34 kandidatë.

parlamentare, ku socialistët parashtruan dy data 23 ose 30 qershor. Ndërkohë, në vend ekziston një situatë e ndezur politike, ku edhe pse opozita ka deklaruar se do të marrë pjesë në zgjedhje, por duke shtuar se nuk mund të ketë

votime me Edi Ramën kryeministër dhe pa shkëputur lidhjet e qeverisë me krimin. Nga ana tjetër, edhe reforma zgjedhore ka mbetur në ngërc, ku palët nuk kanë zhvilluar asnjë mbledhje të komisionit të posaçëm për ndryshimin

e Kodit. Sa u përket kandidatëve, opozita me gjasë do të dalë me emra të përbashkët. Një gjë e tillë është pranuar pak kohë më parë nga kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi.



Ahmet Ajeti



Lulzim Berisha

Tentoi të vriste në atentat Lul Berishën, gjykata refuzon gjykimin e shkurtuar për Ahmet Ajetin

TIRANË - Në Gjykatën e Krimeve të Rënda është zhvilluar paraditen e djeshme seanca gjyqësore për 35-vjeçarin Ahmet Ajeti, i akuzuar si organizator i atentatit ndaj Lulzim Berishës. Avokati i Ajetit kërkoi gjykim të shkurtuar, por kërkesa u refuzua nga gjykata. Ndërkaq,

Lulzim Berisha u përfaqësua nga avokati i tij, Detar Hysi. Në seancën e radhës do të thirren për t'u pyetur Lulzim Berisha, Adriatik Coli, Sardin Sulejmani dhe Endrit Dokle. Ahmet Ajeti u ekstradua në muajin korrik të këtij viti nga Kosova për atentatin e organizuar 13 vite më parë në

Durrës. Për ngjarjen e ndodhur në vitin 2005, ai është dënuar me 20 vite burg në mungesë. Sipas hetimeve të prokurorisë, Ahmet Ajeti dhe kosovari tjetër, Osman Karpuzi u porositën nga Adriatik Coli dhe Endrit Dokle për të eliminuar Lulzim Berishën, kreun e bandës rivale

në qytetin e Durrësit. Pasi se të kryej atentatit, në afërsi të lokalit ku ndodhej objektivi i tyre, Ajeti është konfliktuar me disa persona në panjohur. Në grindje e sipër, ai ka nxjerrë pistoletën duke u vetëplagosur dhe duke bërë që atentati të dështojë. Në dëshminë e dhënë nga i penduari i drejtësisë, Adriatik Coli gjatë procesit gjyqësor, thuhet se dy kosovarët do të paguheshin 100 mijë euro për të kryer vrasjen.

Policia arreston të riun nga Burreli, zbulohet precedenti i vitit 2015

E ekzekutoi në janar 2018, kapet vrasësi i dyshuar i Emiljano Boçit

30-vjeçari dyshohet si vrasës me pagesë

TIRANË

Një 30-vjeçar nga Burreli është arrestuar dje nga policia e Tiranës, pasi dyshohet të jetë autor i vrasjes së Emiljano Boçit. Ngjarje kjo e ndodhur më 14 janar të këtij viti në Tiranë. Bëhet fjalë Tori (Hektor) Xheçuka, i cili u kap nga policia e kryeqytetit në bashkëpunim me prokurorinë. Identifikimi i autorit të dyshuar u bë pas një hetimi disamujor me metoda speciale të hetimit nga Seksioni për Krimet e Rënda në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kapet dhe vihet në pranga Tori (Hektor) Xheçuka, 20 vjeç, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, për veprën penale të "Vrasjes me paramendim" e kryer në bashkëpunim dhe të "Prodhimit dhe mbajtjes së armëve luftarake". 30-vjeçari është autor i dyshuar i ngjarjes së ndodhur në datën 14 janar 2018 në rrugën "Shefqet Musaraj", ku mbeti i vrarë shtetasi Emiljano Boçi, si dhe autor i dyshuar i "Vrasjes së mbetur në Tentativë" të shtetasit M.D. Gazetarja Dorjana Bezat raportoi për "Balkanweb" se i arrestuari dyshohet të jetë vrasës me pagesë. Për arsye hetimi në funksion të zbardhjes së plotë të kësaj ngjarjeje nuk bëhen me dije detaje të tjera. Për vitin 2018, Policia e Tiranës ka zbardhur të gjitha ngjarjet kriminale në fushën e vrasjes dhe të plagosjes.

NGJARJA

Ngjarja e rëndë ndodhi në rrugën "Shefqet Musaraj" në datën 16 janar të këtij viti, ku viktimë u gjet në një mjet



Hektor Xheçuka

i plagosur, por më pas ka humbur jetën në spital. Viktima, Emiljano Boçi, 32 vjeç dhe i plagosuri Melvin Disha, 27 vjeç, shokë me njëritjetrin u qëlluan sapo kish-

in dalë nga një restorant peshku së bashku. Ai dhe shoku i tij i plagosur ishin kthyer nga Gjermania 2 javë para ngjarjes.

PRECEDENTET

Xheçuka në vitin 2015 është arrestuar për vrasje me dashje të mbetur në tentativë. Mësohet se i ri, në atë kohë 27 vjeç, ishte shpallu në kërkim u kap në pikën kufitare "Tre Urat". "Më datë 25.02.2015, ora 11.00, në P.K.K Tre Urat, u kap shtetasi në kërkim Hektor Xheçuka, vjeç 27, banues në Tiranë, për veprën penale 'Vrasje me dashje mbetur në tentativë'. Nenet 7 dhe 22 të Kodit Penal. U njoftua salla Operative e D.P.Q. Tiranë", thuhet në njoftimin e policisë tri vite më parë. Tashmë, Xheçuka, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, akuzohet për vrasjen e Boçit si dhe plagosjen e shokut të këtij të fundit, Melvin Disha.

Ngjarja në Unazën e qytetit, lëndohen dy shoferët

Përplasen dy makina në Elbasan, 6 të plagosur, një grua në gjendje të rëndë

ELBASAN - Një aksident i rëndë ka ndodhur pasditen e djeshme në qytetin e Elbasanit. Si pasojë e ngjarjes janë plagosur disa persona. Incidenti ndodhi në aksin rrugor Elbasan-Librazhd. Në aksident janë përfshirë dy automjete. Paraprakisht raportohet se nga kjo përplasje, një shtetas ka mbetur i plagosur rëndë. Nuk janë të qarta rrethanat e aksidentit.

Njoftimi i policisë "Në Unazën Elbasan, në lagjen



'Emin Matraxhiu', mjeti tip 'Golf' me targa AA 280BU, me drejtues shtetasin Sh.H., 51 vjeç, banues në fshatin Mirakë Librazhd, është për-

plasur me mjetin tip 'Volkswagen', me targa AA 824 HP, me drejtues shtetasin V.D., 25 vjeç, banues në lagjen '5 Maji', Elbasan. Si pasojë e aksidentit janë dëmtuar dy drejtuesit e mjeteve dhe 2 pasagjerë që ndodheshin në këto mjete, të cilët janë transportuar në spitalin e Elbasanit, ku shtetasja K.H., 49 vjeçe, banuese në Librazhd, pasagjere në mjetin me targa AA280BU ndodhet në gjendje të rëndë, ndërsa të tjerët janë jashtë rrezikut për jetën. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e shkakut të aksidentit".

U mbyt në lumin Vjosë, gjendet pas 4 ditësh trupi i 59-vjeçares

FIER - Gjendet trupi i pajetë i 59-vjeçares Manushaqe Nexhipi nga fshati Ferras, e cila që prej ditës së premtë u deklarua e zhdukur nga familjarët e saj. Rreth mesditës së kësaj të hënë rrjedha e Lumit Vjosë e ka nxjerrë trupin e 59-vjeçares afër banesës ku ajo jetonte. Trupi i gruas, e cila sipas bashkëshortit të saj është mbytur në lumin Vjosë është gjetur nga vetë familjarët dhe po sipas bashkëshortit, Manushaqe Nexhipi ka tentuar edhe herë të tjera të kryejë një veprim të tillë. Tre palombarë të forcave RENEA nga Tirana u angazhuan gjatë ditës së diel për gjetjen e 59-vjeçares Manushaqe Nexhipi, por më pas ndërpreu kërkimet. Më herët familjarët kishin bërë kërkime vetë me varka dhe mjete rrethanore. 59-vjeçarja, nënë e dy fëmijëve ishte e paralizuar nga njëra këmbë dhe njëra dorë si dhe vuante nga skleroza sipas familjarëve.

Sherr në familje, djali rreh të atin dhe kushëririn, prish serën

LUSHNJË - Policia e Lushnjës ka vënë në pranga një të ri, që pas një konflikti familjar ka dhunuar babain e tij si dhe kushëririn. Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisarriatin e Policisë Lushnje arrestuan në flagrancë shtetasin Ardit Muço, 24 vjeç, banues në Kamçisht, Lushnje. Arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi në fshatin Kamçisht, tek prona e babait (serat) për motive të dobëta ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj babait të tij, shtetasit F.Muço, 62 vjeç, si edhe ka dëmtuar plasmën e serës. Gjithashtu, shtetasit Ardit Muço ka goditur me mjete të forta djalin e xhaxhait të tij, shtetasin M.Muço, 24 vjeç. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për veprat penale "Dhunë në familje" dhe "Shkatërrim i pronës".

Me dokumente false në Kakavijë, pranga 25-vjeçarit

GJIROKASTËR - Një 25-vjeçar ka përfunduar në pranga të policisë në Gjirokastrë, pasi ka tentuar të kalojë pikën kufitare të Kakavijës me dokumente false. Pas kontrolleve, ka rezultuar se dokumenti i paraqitur rezultoi i falsifikuar në emër të një personi tjetër. I arrestuari është Vasil Selçiotis, 25 vjeç, banues në Fier. Nga specialistët për Hetimin e Krimit Ekonomiko-Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Vasil Selçiotis, 25 vjeç, banues në Fier. Arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi është paraqitur në hyrje të Republikës së Shqipërisë në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë me një dokument udhëtimi (kartë identiteti) të dyshuar të falsifikuar. Pas verifikimeve që u kryen nga shërbimet e policisë, ky dokument ka rezultuar i falsifikuar me të dhëna dhe gjeneralitete të një personi tjetër dhe fotografinë e shtetasit Vasil Selçiotis. Materialet në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë për veprime të mëtejshme, për veprën penale të "Falsifikimit të dokumenteve", neni 186 i Kodit Penal", njoftoi policia.

Mediat e vendit fqinj: Mbi 200 qytetarë do jenë në Bularat në varrimin e 35-vjeçarit

Vrasja e Konstandin Kaçifas, prokuroria pranon kërkesën e familjarëve për tërheqjen e trupit

Avokatët grekë: Do kërkojmë ndërkombëtarizimin e çështjes

TIRANË

Një javë pas vrasjes nga RENE A të ek-stremistit grek, Konstandin Kaçifas, në fshatin Bularat të Gjirokastrës, Prokuroria e Krimeve të Rënda në Tiranë ka pranuar kërkesën e familjarëve të 35-vjeçarit për tërheqjen e trupit, që deri ditën e djeshme mbahej në ruajtje nga Instituti i Mjekësisë Ligjore për shkak të kryerjes së ekspertizës mjekoligjore. Fillimisht ishte avokati i familjes Kaçifas që deklaroi se trupi i këtij të fundit do t'i kthehet familjes ditën e sotme. Sipas tij, autoritetet shqiptare kanë rëndë dakord t'i dorëzojnë trupin e të ndjerit familjes. Avokati Efthimios Navridis tha për 'ANTI' se hetimet për ngjarjen e ndodhur më 28 tetor në fshatin Bularat ku po mbaheshin festime për nder të ditës së Greqisë kanë përfunduar. Ndërkaq, mediat greke bënë me dije se sot do të udhëtojnë drejt Shqipërisë mbi 2 mijë persona për të marrë pjesë në funeralin e Konstandin Kaçifas. Për këtë arsye, në zonë do të ketë prani të shtuar të policisë për të shmangur çdo incident apo tension edhe të importuar nga grupe ekstremiste apo radikale që do të vinë nga jashtë.

DEKLARATA E AVOKATËVE TË KONSTANDIN KAÇIFAS

Familja Kaçifas ka inkudruar avokatit e njohur grek për çështje penale, zyrën top-ligjore greke të Aleksandros Likurezoz. Në kanalin televiziv "ANTI", Likurezoz ka deklaruar se në fazën e parë synojnë në marrjen e trupit dhe varrimin e Kaçifas, që pritet të realizohet sot e si fazë dytë në ndërkombëtarizimin e çështjes. Likurezoz ka deklaruar se qëndrimi i au-



Konstandino Kaçifas

KËRKESA

Familjarët e Konstandino Kaçifas, i cili mbeti i vrarë nga RENE A në Bularat të Gjirokastrës disa ditë më parë bënë kërkesë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për tërheqjen e trupit të 35-vjeçarit. Pas vrasjes, familja pati pretendime për trupin e të riut dhe akuzoi RENE A-n se fillimisht e kishte plagosur dhe më pas e kishte vrarë. Por, avokati i familjes, i cili e pa trupin u shpreh se i riu nuk ishte vrarë nga afër, por nga larg. Janë mjekët ligjore, që do të thonë fjalën e fundit, për mënyrën sesi është qëlluar ndaj Kaçifas dhe distancën prej nga është qitur me armë në drejtim të tij.

toriteteve shqiptare me hapjen e dosjes ligjore kundër të vdekurit, ngritja e padisë për çështje penale, akuzat për tentativë të vrasjes së funksionarëve të shtetit përbën një "paradoks prototip" që "diçka fshihet dhe që duhet parë me vëmendje", por edhe duhet kërkuar drejtësi me ndërhyrje ndërkombëtare.

Ndërsa, sipas avokatit tjetër, Efthimios Navridis, trupi nuk u dorëzua nga frika e episodeve në fundjavë, sipas policisë shqiptare, ndërsa vlerësoi se kjo kërkesë pritet të plotësohet deri të martën (ditën e sotme).

MEDIAT GREKE

Trupi i pajetë i Konstandinos Kaçifas deri mbrëmë ndodhej në Mjekësinë Lig-



Prindërit e 35-vjeçarit të vrarë

jore në Tiranë, me qëllim kryerjen e ekspertizës së thelluar. Media greke "Kathimerini", përmes një artikulli të publikuar ditën e djeshme shkruante se dilema dhe pikëpyetja e madhe është se nëse kjo ngjarje do të shënojë fillimin e një "përplasjeje", e cila mund të prodhojë ftohje të marrëdhënieve diplomatike. Sipas saj, në ceremoninë e lamtumirës së 35-vjeçarit do të jenë të pranishëm 2000 mijë qytetarë grekë, kryesisht nga pjesa veriore e Greqisë. "Të dhënat flasin për të paktën

2 mijë qytetarë të Vorio-Epirit që përgatiten të shkojnë me autobusë në Bularat. Klima në minoritetin grek është përkeqësuar, në të njëjtën kohë edhe një pjesë e madhe e shoqërisë shqiptare duket se është pushtuar nga nacionalizmi", shkruhet mes tjerash në artikull. Minoritari grek, i cili mbeti i vrarë pas shkëmbimit të zjarrit me forcat RENE A një javë më parë, pas ekspertizës së detajuar në Tiranë do të përcillet në banesën e fundit në Bularat të Dropullit në Gjirokastrë.

2.000

PERSONA

Media greke "Kathimerini", përmes një artikulli të publikuar ditën e djeshme shkruante se dilema dhe pikëpyetja e madhe është se nëse kjo ngjarje do të shënojë fillimin e një "përplasjeje", e cila mund të prodhojë ftohje të marrëdhënieve diplomatike. Sipas saj, në ceremoninë e lamtumirës së 35-vjeçarit do të jenë të pranishëm 2000 mijë qytetarë grekë, kryesisht nga pjesa veriore e Greqisë.

Ekzekutohet "gangsteri" grek John Macris, mediat: Vrasësi është shqiptar

John Macris, i njohur si një nga të fortët dhe njëherësh më të famshmit në Sidnei dyshohet se mund të jetë ekzekutuar nga një shqiptar, i cili raportohet se e ka vrarë kundrejt pagesës. Mediat e huaja raportojnë dhe hedhin dyshime të forta se ai mund të jetë vrarë pas një përleshje mes grupeve mafioze në Greqi, aty ku raportohet se funksionojnë edhe grupet shqiptare. Mediat e huaja teksa citojnë të njëjtin burim, shkruajnë se nga përplasja e ashpër mes bandave janë shënuar të paktën 7 vrasje që nga fillimi i vitit, përcjell www.smh.com.au. Mësohet se "gangsteri" i Sidnei do të përcillet për në banesën e fundit në një kishë ortodokse greke në Australi. Autoritetet kanë nisur hetime intensive dhe një ndër pistat kryesore është ajo e porositjes me pagesë, teksa si të dyshuar për vrasjen mbahen shqiptarët. "Këto lloj vrasjeje bëhen



John Macris

kryesisht nga shqiptarë të paguar, që përdorin dy ose tre makina ose motoçikleta që të arratisen nga Greqia menjëherë pasi kanë kryer ekzekutimin", - shkruajnë mediat e huaja. Por krahas pistës së vrasjes me pagesë, autoritetet po hetojnë edhe në aktivitetin e 46-vjeçarit, i cili së fundmi kishte hartuar plane të investonte në industrinë e sigurisë. Macris kishte një profil të ulët në Greqi

dhe emri i tij u bë publik në vitin 2016, kur u martua me modelen, Viktoria Karynda, e lindur në Ukrainë, në ishullin e Mykonos. Ai u vra jashtë shtëpisë, ndërsa nga pamjet e kamerave të sigurisë tregohet se ekzekutori i është afruar në këmbë dhe më pas e ka qëlluar duke e lënë të vdekur. Siç raportohet, ekzekutori i cili dyshohet të jetë shqiptar ishte i gjatë rreth 170 centimetra.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 14,760,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërke me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 05 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

UNAZA E RE PROJEKTI



Projekti i Unazës së Madhe të Tiranës nga Shkolla Teknologjike, deri te sheshi "Shqiponja"



Nyja "Shqiponja" e projektit të ri të Unazës së re


Afrim Qendro: Janë bërë verifikimet e dokumenteve për objektet. Vlera, 5.98 miliardë lekë

Projekti i Unazës së Madhe, shpallen fituesit për segmentin 2.34 km

Proces shpronësimesh, banesat e legalizuara përfitojnë dëmshpërblim

Drejtesit e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Hipotekës, ALUIZNI-t dhe Bashkisë Tiranë komunikuan me median për të dhënë detaje mbi projektin e Unazës së Madhe të kryeqytetit. Projekti i Unazës parashikon ndër të tjera edhe një proces shpronësimesh ku ata që kanë dokumentet për banesat që do të shemben do të përfitojnë dëmshpërblim ndërsa ata që nuk kanë dokumente e që janë në proces legalizimi, do të skualifikohen e do të kalojnë në një proces tjetër, atë të mbështetjes për strehimin nga programet e Bashkisë së Tiranës. E në këtë kuadër, është publikuar edhe skica e projektit dhe harta e shpronësimeve. "Një video shpjeguese për të kuptuar se si do të rikualifikohet Unaza e Madhe e Tiranës nga Shkolla Teknologjike deri tek Sheshi Shqiponja. Rruga e Unazës së re është konceptuar si rrugë kategoria "A Urbane" me seksion tip me tri korsi për çdo sens lëvizjeje me shpejtësi qarkullimi 80km/h. Përfundimi i veprës do të garantojë një rrugë me standardet më të mira evropiane ashtu sikurse do t'i japë zgjidhje trafikut tejet të rënduar në këtë zonë të kryeqytetit", thotë ARRSH në reagimin e saj. Në projektin e ri parashikohet që unaza e re të jetë me tre korsi në të dy senset dhe me shpejtësi të lejuar deri në 80 km në orë. Po ashtu në zonën e Astirit parashikohet një nënkallim. Për të lehtësuar qarkullimin në urën e Lanës parashikohen dy nivele kallimi. Dhe dy nënkallime të tjera përgjatë Lanës. Një ndryshim të plotë do të ketë dhe sheshi "Shqiponja", i cili do të jetë me tri nivele kallimi. Aktualisht në të qarkullojnë 4000 mjete në orë nga 2 mijë që lejohet.

Drejtori i Autoritetit



Nyja tip e projektit të ri të unazës së madhe

AFRIM QENDRO

Drejtori i Autoritetit Rrugor të Shqipërisë, Afrim Qendro ka bërë të ditur se janë bërë verifikimet e dokumenteve për objektet që shemben në ndërtimin e rrugës në Shkozë dhe në Unazën e Re. Në total ky segment ka një gjatësi prej 2.34 km, ndërkohë që vlera e tij me TVSH është 5.98 miliardë lekë. Për lotin e parë, që ka një gjatësi prej 0.76 km fitues është shpallur bashkimi i operatorëve "Biba X & DH Albania", me një vlerë prej 2.24 miliardë lekë pa TVSH.

Rrugor të Shqipërisë Afrim Qendro ka bërë të ditur se janë bërë verifikimet e dokumenteve për objektet që shemben në ndërtimin e rrugës në Shkozë dhe në Unazën e Re. Në total ky segment ka një gjatësi prej 2.34 km, ndërkohë që vlera e tij me TVSH është 5.98 miliardë

lekë. Për lotin e parë, që ka një gjatësi prej 0.76 km fitues është shpallur bashkimi i operatorëve "Biba X & DH Albania", me një vlerë prej 2.24 miliardë lekë pa TVSH. Loti 2 do të ndërtohet nga kompania Sallilari. Kosto e kontratës për këtë segment prej 0.84 km është 1.66 miliardë lekë,

ndërkohë që për segmentin e tretë prej 0.74 km fitues është shpallur kompania "Victoria Invest Internacional & Viktoria Invest" me një vlerë prej 1.17 miliardë lekë pa TVSH.

Paralelisht ARRSH po planifikon të ndërtojë edhe një segment të ri nga sheshi

57.7

**MILIONË LEKË
TENDERIMI
PUBLIK**

Bashkia e Tiranës ka hapur procedurat e tenderimit publik për ndërtimin e rrugëve të bllokut pranë ish-"Astirit", duke vënë në dispozicion një fond limit prej më shumë se 57.7 milionë lekë për këtë investim.

2.34

**KM
SEGMENT**


Drejtori i Autoritetit Rrugor të Shqipërisë, Afrim Qendro ka bërë të ditur se janë bërë verifikimet e dokumenteve për objektet që shemben në ndërtimin e rrugës në Shkozë dhe në Unazën e Re. Në total ky segment ka një gjatësi prej 2.34 km.

'Shqiponja' të Bulevardi i Ri, i cili parashikohet të shtrihet në Veri të kryeqytetit ose në Jug të Njësisë Administrative të Paskuqanit. Ndërkëq, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjijnuri ka deklaruar se Unaza e Madhe do të jetë tërësisht e përfunduar brenda 3 vitesh.

TENDERI

Bashkia e Tiranës ka hapur procedurat e tenderimit publik për ndërtimin e rrugëve të bllokut pranë ish-Astirit, duke vënë në dispozicion një fond limit prej më shumë se 57.7 milionë lekë për këtë investim. Ky bllok ndodhet pranë rrugës "Teodor

Keko", i njohur si zona e ish-Astirit dhe kufizohet nga rrugë 'Aleksandri i Madh', 'Tom Plezha' dhe 'Mikel Marulli'. Bazuar në dokumentet e publikuara pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, pjesë e projektit janë gjithashtu edhe rruga 'Jata' si dhe rruga paralele më të. Gjendja aktuale e këtyre segmenteve rrugore paraqitet e amortizuar, ku nga inspektimet e kryera rezultuan të ujërave të zeza e të bardha. Nisur nga kjo, është parë e domosdoshme vendosja e rrjeteve të reja për disiplinimin e ujërave të zeza e të bardha.



Mbikalimi i projektit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Shkolla Teknologjike deri te sheshi "Shqiponja"

"Kur të na vrasin, le të bëjnë atë që kanë nisur. Qeveria po tallet me ne"

Banorët e zonës së Unazës së Re vazhdojnë protestën kundër shembjes së banesave

"Kërkojmë dëmshpërblim në vlerë reale për shtëpitë tona"



Voltiza Duro

Për të tretën ditë radhazi, banorët e zonës së Astirit në kryeqytet kanë protestuar kundër prishjes së banesave dhe bizneseve pasditën e djeshme. Ata kanë bllokuar rrugën dhe janë shprehur se i kanë banesat e tyre në proces legalizimi, ndërsa nuk do lejojnë prishjen e tyre. "Kur të na vrasin neve, atëherë le të bëjnë atë që kanë nisur. Do bëhemi lugetër edhe do i mbysim. Qeveria po tallet me ne. Nuk tërhiqemi!"-janë shprehur qytetarët të revoltuar. Ata kërkojnë me ngulm një dëmshpërblim real për shtëpitë e bizneset e tyre dhe theksojnë se nuk do të heqin dorë deri sa të fitojnë të drejtën e tyre. "Banesën e kam në proces legalizimi, e kështu si po vjen situata nuk e dimë nëse do të na i legalizojnë, pasi nuk iu intereson. Ne kërkojmë dëmshpërblim, të vijmë instancat përkatëse dhe të bëjnë vlerësimin real të banesës. Protesta do të vijojë deri sa të gjejmë të drejtën tonë. Kemi punuar një jetë për këtë shtëpi e nuk mund ta prishin si pa të keq, e aq më tepër të na lejnë një afat 10 ditor. Është absurde. Kemi gjithë këto vite që i paguam një taksat shtetit, drita e ujë, nëse kishte diçka që nuk shkonte, mund të na lajmëronin më parë", -thotë një tjetër banore. Ndërkohë për shkak të protestës

është krijuar kaos në qarkullimin e mjeteve. Konkretisht në rrugën e Kavajës dhe te zona 21 Dhjetorit. Po ashtu kaos në trafik është krijuar nga mbikalimi i Unazës së Re deri tek sheshi "Shqiponja" te Dogana. Banorët prej dy orësh kanë bllokuar rrugën dhe kanë paralajmëruar se nuk do të lejojnë prishjen e shtëpive të tyre pa i shpronësuar ashtu siç u takon apo pa u gjetur banesa të reja. Ata nuk pranojnë propozimin e Bashkisë Tiranë që të gjejnë banesa me qira, e cila do të paguhet nga bashkia, pasi nuk është një zgjidhje afatgjatë.

OBJEKTET

Aktualisht janë 317 objekte që do të preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe, dhe 163 prej tyre që janë në proces legalizimi do të skuallifikohen nga ALUIZNI. Banorët e kundërshtojnë projektin sepse sipas tyre është zgjeruar përtej përmasave të projektit fillestar. Banorët bëjnë me dije më tej se projekti ka marrë një zgjerim shumë më të madh nga sa ishte planifikuar më parë, përkatësisht nga 7 metra është shtrirë në 35 metra.



TRAFIKU

Ndërkohë për shkak të protestës është krijuar kaos në qarkullimin e mjeteve. Konkretisht në Rrugën e Kavajës dhe te zona 21 Dhjetorit. Po ashtu kaos në trafik është krijuar nga mbikalimi i Unazës së Re deri tek sheshi "Shqiponja" tek Dogana. Banorët prej dy orësh kanë bllokuar rrugën dhe kanë paralajmëruar se nuk do të lejojnë prishjen e shtëpive të tyre.

Grafiku i punimeve në Unazën e Madhe, ja çfarë do të ndryshojë

Ndërkohë, grafiku i punimeve përfshin, gjithashtu, ndërtimin e një sipërfaqe të gjelbër, cka mungon në këtë zonë, si dhe vendosja e sinjalistikës rrugore vertikale e horizontale. Është projektuar gjithashtu krijimi i hapësirave për parkim dhe rezervë për internet e telefon si dhe vendosja e koshave në çdo 3 shtylla ndriçimi, për shkak të mungesës së hapësirave të tjera. Po ashtu, gjatë hartimit të projekt-zbatimit është parashikuar të prishen një sërë ndërtimesh (krye-

sist lokale) që zënë hapësirat e bllokut. Të gjitha rrugët e këtij blloku bani mi janë parashikuar me gjerësi 3.5 metra me një sens. Vetëm në një segment të caktuar ku ka parkim nën pallate rruga do të jetë me dy sense kalimi për të lejuar futjen dhe daljen e automjeteve nga parkimi. Ndërsa sa i takon grafikut të punimeve, parashikon një kohështirje prej 19 javë kalendarike.

në pjesë të tjera me kënd 45 gradë. Ndërsa, do të bëhet edhe vendosja e sistemit të ndriçimit, pasi në këtë bllok mungon plotësisht ndriçimi publik. Investimi përfshin edhe ndërtimin e linjave rezervë për internet e telefon si dhe vendosja e koshave në çdo 3 shtylla ndriçimi, për shkak të mungesës së hapësirave të tjera. Po ashtu, gjatë hartimit të projekt-zbatimit është parashikuar të prishen një sërë ndërtimesh (krye-

"Në fillim, pra në 2017, në bazë të informacioneve që kemi, projekti shtrihej në 7 metra thellësi. Ndërsa tani e kanë shtrirë në 35 metra e preken shumë më shumë familje sesa më parë. Më kanë thënë që dëmshpërblimi që do të marr për shtëpinë është 10 milionë lekë të vjetra, por shtëpia ime nuk vlen kaq. Me 10 milionë as një garsonierë nuk blen dot e jo më shumë", -thotë një prej banorëve gjatë protestës.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve është përcaktuar data 30 janar 2019

Investimet në bujqësi, AZHBR hap aplikimet për fermerët

Kush janë përfituesit e sa janë vlerat që përfitojnë

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural e Shqipërisë përmes një njoftimi paraprak ka shpallur thirrjen e parë për dorëzimin e aplikimeve në kuadër të Programit IPARD II. Thirrja për aplikime do të hapet më 30 nëntor 2018 dhe zgjat 60 ditë. Ajo është hapur për të gjithë personat, puna dhe veprimtaria e të cilëve zhvillohet brenda Shqipërisë në fushat e prodhimit bujqësor ose të agro-përpunimit dhe rural me fokus në disa masa, që përfshijnë konkretisht:

"Investimet në asetet fizike të fermave bujqësore" me fokus të veçantë në sektorët: qumësht, mish, fruta, perime dhe vresht.

"Investimet në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore" me fokus të veçantë në sektorët: qumështi dhe përpunimi i qumështit, përpunimi i mishit, përpunimi i frutave dhe perimeve dhe vera.

"Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit" me fokus të veçantë në sektorët e mëposhtëm;

Prodhimi i bimëve medicinale aromatike, kërpudhave, mjaltit, bimëve dekorative dhe kërmijve;

Përpunimi dhe tregtimi i bimëve medicinale dhe aromatike të egra dhe të kultivuar, kërpudhave dhe mjaltit;

Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore;

Akuakultura;

Turizmi i natyrës dhe ai rural;

Shërbime për popullsinë dhe bizneset rurale;

Industria e artizanatit dhe punishtet e prodhimit;

Prodhimi dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme.



Foto ilustruese

INVESTIMET

Investimet në asetet fizike të fermave bujqësore" me fokus të veçantë në sektorët: qumësht, mish, fruta, perime dhe vresht. Në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore" me fokus të veçantë në sektorët: qumështi dhe përpunimi i qumështit, përpunimi i mishit, përpunimi i frutave dhe perimeve dhe vera dhe në sektorët e prodhimit të bimëve medicinale aromatike, kërpudhave, mjaltit, bimëve dekorative dhe kërmijve.

Buxheti i vënë në dispozicion të kësaj thirrjeje kap vlerën e 50.3 milionë euro, nga të cilat 37.7 milionë euro janë kontribut i BE-së dhe pjesa e mbetur, 12.6 nga buxheti i shtetit.

Masa 1: me buxhet total 21.6 milionë euro, me një minimum prej 10 000 euro dhe maksimum 500 000 euro. Përqindja e mbështetjes është 60% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të in-

vestimit, 65% nëse investimi bëhet nga një fermer i ri (nën 40 vjeç), 70% për investimet në zonat malore.

Masa me buxhet total 20.3 milionë euro, me një minimum 25 000 euro dhe maksi-

50.3

MILIONË EURO

Buxheti i vënë në dispozicion të kësaj thirrjeje kap vlerën e 50.3 milionë euro, nga të cilat 37.7 milionë euro janë kontribut i BE-së dhe pjesa e mbetur, 12.6 nga buxheti i shtetit. Masa 1: me buxhet total 21.6 milionë euro.

60

DITË

Thirrja për aplikime do të hapet më 30 nëntor 2018 dhe zgjat 60 ditë. Ajo është hapur për të gjithë personat, puna dhe veprimtaria e të cilëve zhvillohet brenda Shqipërisë në fushat e prodhimit bujqësor ose të agro-përpunimit dhe rural me fokus në disa masa.

mum 2 000 000 euro. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 50% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Masa 7: me buxhet total 8.3 milionë euro, me një minimum 10 000 euro, maksimumi 400 000 euro. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 65% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Informacionet lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët, kriteret e përzgjedhjes si dhe reg-

ullat e dorëzimit të aplikimeve gjenden në udhëzuesit për aplikantët, i cili mund të kërkohet si një kopje fizike në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe pranë AZHBR-së gjatë orëve të punës 08:00-16:30 ose mund të shkarkohet nga faqja e internetit www.azhbr.gov.al dhe <http://www.bujqesia.gov.al>.

Sa i takon afatit të fundit për pranimin e aplikimeve, është përcaktuar data 30 janar 2019.

Pesëvjeçari i fundit, më shumë se 97% rritje

Dyfishohet çmimi i frutave dhe perimeve, statistik

Cmimet e frutave dhe perimeve në Shqipëri pothuajse janë dyfishuar në pesë vitet e fundit. Po të krahasojmë indeksin mesatar të çmimeve të konsumit për vitin e kaluar me atë të vitit 2012, çmimet e prodhimeve të freskëta bujqësore kanë njohur një rritje të jashtëzakonshme.

Më konkretisht, çmimet e grupit të perimeve janë rritur me 97%, ndërsa ato të grupit të frutave me 86%. Çmimet e këtyre produkteve janë rritur ndjeshëm edhe gjatë nëntë muajve të parë të këtij viti, ku rritja është më e theksuar sërisht të perimet. Shtrenjtimi i fortë i prodhimeve kryesore bujqësore rrit skepticismin lidhur me valën e entuziazmit që ka karakterizuar retorikën politike të qeverive të fundit, kur flitet për bujqësinë. As të dhënat e prodhimit

kombëtar nuk tregojnë rritje domethënëse të këtij sektori, ndërsa, nga ana tjetër, shtrenjtimi i tyre tregon për një ofertë që, në raste të mirë, nuk është rritur mjaftueshëm. Në pesë vitet e fundit, çmimet e gjithë grupit të ushqimeve janë shtrenjtuar me 20%. Kjo siguri që ka rëndur buxhetet familjare, po të kemi parasysh se ushqimet zënë rreth 39% në shportën e shpenzi-

meve familjare që përdoret si referencë për llogaritjen e inflacionit. Rritja e çmimeve është mjaft e theksuar te

perimet dhe frutat, megjithatë, shtrenjtimi i fortë në këto grupe është ekuilibruar pjesërisht nga rënia e çmimeve në grupet e produkteve ushqimore të përpunuara, çmimet e të cilave lidhen kryesisht me importin dhe koniunkturën e tregjeve ndërkombëtare.

Në pesë vjet, çmimi i bukës për shqiptarët nuk është shtrenjtuar, përkun-



drazi, ka rënë mesatarisht me 1%. Ndërsa çmimi i mishit, tjetër produkt i rëndësishëm në dietë dhe në shportën e shpenzimeve, është rritur me vetëm 0.7%

në harkun e pesë viteve. Rënie të çmimeve kanë pësuar edhe vajrat ushqimore, me 8.8% dhe sheqeri e ëmbëlsirat, me 2.2%. TV SCAN

BUKA

Në pesë vjet, çmimi i bukës për shqiptarët nuk është shtrenjtuar, përkundrazi, ka rënë mesatarisht me 1%. Ndërsa çmimi i mishit, tjetër produkt i rëndësishëm në dietë dhe në shportën e shpenzimeve, është rritur me vetëm 0.7% në harkun e pesë viteve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHIPALLJE ANKANDI

Më datë 01 Dhjetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shitjen e apartamentit nr. 3/218+1-18, vol 35, fq.39, ZK.8350, sip. 103.90 m² me çmim fillestar 57120 lek/m².

Apartamenti ndodhet në Tiranë (prapa Prokurorisë Rrethit Tiranë).

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Perbarimorë L.D.C

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Perbarimorë L.D.C
-Apartamenti me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m², ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tiranë. Çmimi fillestar per shitje eshte 4.700.000 Lek.

Data e shpalljes 11.09.2018
Data e zhvillimit 11.10.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimorë L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

Opinioni *i* Ditës

Për shkollën e të nesërme

Nga Pëllumb Karameta

Kushdo e ndjen shqetësimin për ndryshimin e dëshiruar në arsim. Në vendin tonë ai shprehet kryesisht, ose si kontribut për përmirësimin e formave të organizimit, të strategjive dhe / ose të teknikave ekzistuese të nxënies, ose si kritikë për aspekte të caktuara, si tekstet mësimore, menaxhimi i burimeve, infrastruktura shkollore etj. Ka diskutime, por një pjesë e madhe e tyre ngjajnë më shumë me slogane që nënkuptojnë çdo gjë dhe asgjë (kurrikula bashkëkohore, mësimdhënia me nxënësin në qendër, metodat ndërvepruese, tekstet alternative etj.) Njëherazi, shumica e punimeve në konferencat shkencore apo kurrikulat universitare e deri te programet e ofruara nga agjenci trajnuese vendase dhe të huaja, nuk po arrijnë të skicojnë "shkollën e të nesërme". Skicë të cilën mendimi arsimor ndërkomëtar ka vite që po e dizajnon. Ndoshta gabojmë, por na duket që studiuesit tanë (akademikë, pedagogë apo kërkues të tjerë), ende, nuk po ia dalin të reflektojnë përpjekjet që shqyrtojnë pyetjet për rolin dhe qëllimet e arsimit në një botë me nivel të paprecedentë kompleksiteti, ndryshueshmërie dhe pasigurie. Në shkrime të ndryshme, kemi informuar rreth tendencave që sfidojnë jo pak modelin arsimor ekzistues, me rrënjë në shekullin 19 e të jetësuar në të 20-in. Njëherazi, për sfidat serioze që mund të karakterizojnë botën e shekullit të 21-të, sfida të "idhëta" këto, tejet komplekse, të pasigurt dhe të mbarsura me paqartësi në fushat sociale, ekonomike, politike, mjedisore, ligjore dhe morale. Që, nëse nuk njihen dhe përballen, do ta faktorizojnë edhe më shumë mospërshtatjen e arsimit që japim me edukimin që nevojitet. Në vijim, shtjellohen dy zhvillime: (1) kuptimet e reja rreth "dijes" dhe "njohurisë" dhe (2) nevoja për sisteme arsimore të bazuara në ato që dimë tani rreth mënyrës si nxënë njerëz.

Zhvillimi i parë lidhet me mbizotërimin e referencës socio-konstruktiviste në arsim. Sipas saj, "njohuria" dallon nga "dija" (Ph. Jonnaert, 2007), dallim ky me ndikime të drejtpërdrejta mbi kurrikulën dhe proceset / produktet e shkollimit.

Njohuritë lidhen me personin që i ndërton; pra, janë personale. Ato nuk transmetohen nga mësuesi / pedagogu; përkundrazi, ndërtohen nga subjekti që nxë. Njohuritë ruhen nga ai, për aq kohë sa mund t'i zbatojë, çka dhe e bën kompetent në një sërë situata. Këto të fundit duhet të jenë jo vetëm domethënëse për subjektin, por dhe të lidhura me praktikën shoqërore. Janë këto praktika, në fakt, që pa ndërprerje bëjnë verifikimin e njohurive të ndërtuara. Thënë ndryshe, nuk janë përmbajtjet e disiplinave / lëndëve mësimore përcaktuesit e mësimin / nxënies, por janë situatat ku subjekti përmes veprimit mund të provojë sa të zbatueshme janë njohuritë që ndërton.



Verifikimi i vlerës së tyre kërkon praktikën dhe reflektimin etj. Nga këndshikimi i teorisë socio-konstruktiviste, njohuritë nuk transmetohen; ato ndërtohen nga subjekti përmes veprimit në situata dhe reflektimit mbi veprimin; ato janë të zbatueshme përkohësisht; ato kërkojnë medoemos praktikën për të verifikuar vlefshmërinë; ato lidhen ngushtë dhe ndërtohen në situata, duke respektuar standardet e pranuarra. Si të tilla, njohuritë pasqyrojnë dijet, janë dinamike dhe veprojnë si procese përmes të cilëve ndërtohen dijet të reja.

Tradicionalisht, me termin "dije" janë nënkuptuar të vërtetat e strukturuar dhe të përkrahura nga veprat e specializuara, në manuale, në dokumente të tjera apo në doracakët profesionale, të vërteta që janë provuar, pranuar dhe vlerësuar nga shoqëria. Dijet janë produkt i veprimtarisë së komuniteteve të dijetarëve. Nisur nga çasti që shoqëria i njeh, ato vlerësohen dhe kodifikohen, p. sh., në programet e studimit, që të mund të njihen dhe të ndahen mes të interesuarve, por pa harruar relativitetin e tyre. Si të tilla, dijet e kodifikuan si tekste u përgjigjen logjikave të disiplinave përcatëse, ose praktikave shoqërore nga ku kanë gjeneruar. Pasi konfirmohen dhe kodifikohen, ato i referohen dhe kodit gjuhësor. Andaj, dijet i përgjigjen një logjike të dyfishtë: (1) logjikës së disiplinës ose praktikës shoqërore, të cilës i referohet; (2) logjikës gjuhësore që është sintaksa dhe semantika. Sapo dija ndërtohet (ose rindërtohet) nga subjekti, ajo bëhet njohuri

ri për këtë të fundit. Ndaj, nuk mund të ketë përputhje ndërmjet "dijëve" të kodifikuara si tekste, "dijëve" që shtjellohen pedagogu dhe "njohurive" që ndërton nxënësi / studenti. Kur flasim për dije, kemi parasysh përmbajtjet e programeve të studimit, të teksteve shkollore etj., pra, përmbajtjet disiplinore. Kur flasim për njohuri, i referohemi trashëgimisë njohëse të subjektit. Konceptuar kësajso, mund t'i qasemi zonës së shndërrimit të dëshiruar nga "homo sapiens" në "homo faber" përmes shkollimit.

Zhvillimi i dytë është ndryshimi në mënyrën se si mendohet dhe përdoret dija. Sot pranohet se, ajo që mëson nxënësit / studentët, nuk përputhet mirë me mënyrën se si janë organizuar sistemet arsimore. Ekziston dyshimi në rritje - nëse mjafton ose jo - përmirësimi i asaj që po bëhet në shkolla, për t'i pajisur të rinjtë për jetën dhe punën në shekullin e ri. Tabela ilustron disa aspekte të këtij ndryshimi.

MË PARË

"Dija u konceptua si diçka e zhvilluar dhe e njohur nga ekspertët, diçka që mund të kalojë nga mësuesi të nxënësit ose nga menaxheri te punëtori.

TANI

"Dija krijohet shpejt, çdo ditë. Dija është procesi i krijimit të dijeve të reja; produkt i "rrjetëve dhe rrjedhave të dijes" që përfshihen përmes ndërveprimeve dhe të kryqëzimeve, pikërisht në kohën e duhur, për të zgjidhur probleme specifike më kohë reale.

MË PARË

"Puna e shkollave ishte ta përcillnin dijen tek nxënësit dhe

puna e këtyre të fundit ishte ta përrthnin atë, në përgatitjet për jetën e tyre pas shkollës.

Zhvillimi i kurrikulës shihet si përcaktimi i dijeve për të cilat do të kishin nevojë nxënësit për të lozur rolet e tyre të ardhshme. Dija organizohet logjikisht në sekuenca temash që mund t'u mësohen nxënësve nga mësuesi me metodat e paraqitjes hap pas hapi dhe vlerësohet arrijta e tyre.

TANI

"Nuk mund të parashikohet saktësisht se cila dije do të nevojitet të ndërtohet nga nxënësit si njohuri, në të ardhmen. Është argumentuar se nxënësit do të kenë nevojë, ndër të tjera, të krijojnë ndjenjën e identitetit, të bëhen të vetëdijshëm, mendimtarë krijues dhe kritikë, të jenë në gjendje të marrin iniciativë, të punojnë në ekipe dhe të jenë të aftë të nxënë gjatë gjithë jetës së tyre.

MË PARË

"Shkollat u stabilizuan si struktura që përcaktinin llojet e vendeve të punës dhe rolet sociale që mund të lozin nxënësit, pasi të përfundonin shkollën.

TANI

"Llojet e vendeve të punës dhe rolet sociale që do të lozin nxënësit pasi të shkollohen, evoluojnë vazhdimisht si pasojë e zhvillimeve shoqërore, ekonomike dhe teknologjike, në një botë gjithnjë e më të globalizuar, të ndërlidhur dhe të ndërvarur. Në shoqëri të shekullit 21, ata që do të arrijnë të punojnë me dijen, do të shihen si burimi kyç për zhvillimin ekonomik dhe social.

Më përmbledhur: "Dija nuk shi-

het më si mendimi për "diçka" e prodhuar nga mendimi njerëzor dhe e kodifikuar më pas nëpër disiplina nga ekspertë të veçantë. . . dija nuk është diçka që mund të përcaktohet, të zbulohet, të depozitohet dhe të matet, por është forcë gjeneruese, fluide dhe dinamike ose potenciali për të bërë gjëra. . . dija është diçka që ndërtohet bashkërisht nga ekipet e njerëzve, diçka që ndodh në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Është proces më shumë se produkt, është diçka që ndryshon, evoluon, rrjedh dhe rigjeneron veten përhër në formë të reja" (M. Castells (2000). Këtë kuptim të ri të dijes e parashikoi, në mesin e viteve 70-të, filozofi frëng J-F Lyotard. Sipas tij, "në të ardhmen, dija do të jetë e rëndësishme, jo si në të shkuarën për shkak të marrëdhënive me të vërtetën, arsyen dhe sigurinë, por për atë që quhet "zbatim" i saj, energji ose aftësi për të bërë gjëra, për "vlerën e përdorimit" të saj. . . si pasojë, kufijtë disiplinorë tradicionalë do të treten; metodat tradicionale që paraqesin dijen, librat, artikuljet dhe ekspertët e veçantë do të jenë më pak të rëndësishëm; për nxënësin do të zhvillohen koncepte të reja". Ide si këto bëjnë që shkollat dhe universitetet, në vend që ta përhapin dijen duke theksuar disiplinat, të marrin përgjegjësinë për t'i ndihmuar nxënësit / studentët të planifikojnë, të menaxhojnë, të përzgjedhin, të përdorin, të organizojnë, të zbatojnë dhe të vlerësojnë me efikasitet idetë dhe informacionin.

Theksi mbi nxënësin përmes veprimit u jep përparësi zhvillimit të kapaciteteve, aftësi ose kompetencave të nxënësve / studentëve për t'u marrë me situata dhe mjedis të reja, përfshirë ato me shkallë të lartë kompleksiteti, ndryshimi dhe pasigurie. Kjo nuk do të thotë aspak që dija nuk ka rëndësi, ose që kurrikula shkollore të ndërtohet pa qëllime për zhvillimin e njohurive të nxënësve. Përkundrazi. Idetë e reja shqyrojnë që idetë tona të vjetra rreth asaj se për çfarë dije kanë nevojë nxënësit / studentët nuk janë më të mjaftueshme. Në vend të kësaj - theksojnë kërkuesit - ne duhet të miratojmë pikëpamje shumë më komplekse për dijen, pikëpamje që përfshijnë dijen, veprimin e subjektit dhe qenien e tij. Duke vepruar kështu, do na duhet t'i rishikojmë idetë tona për mënyrën se si mësimi në shkollë / auditor mund t'i ndihmojë subjektet të zhvillohen.

Çka po e sfidon arsimin dhe shkollën kudo në botë janë idetë rreth nxënies që mbështeten mbi dy epistemologji konkurruese, por mjaft të ndryshme për çka llogaritet si dije: ideja e shekullit 20 që e konceptonte atë si përmbajtje disiplinore / lëndore e që duhet transmetuar dhe ruajtur në kujtesë dhe pikëpamja e shekullit 21 për dijen si gjëja më të cilën bëhen gjërat. Kjo përzierje e ideve tejet të ndryshme rreth dijes është problem. Zgjidhja e të cilit përmban vetëm një nga aspektet kyçe për skicimin e shkollës së të nesërme.

Tiranë, më 05. 11. 2018

Vajza e aktores: Jam rritur në skenë me mamën, kështu që them se është gjenetike

Roza Lati, si personazhi më "In", fama dhe të fshehtat e moderatores

"Zgjedha të puth Feron, sepse atë ma bënë për të dashur"

Egla Xhemali

Ajo është një nga personazhet më të dashura për publikun. Bëhet fjalë për Roza Latin, moderatoren e njohur, që ka rrëmbyer zemrat e të rinjve me stilin dhe natyrën e saj solare. Për "Gazeta shqiptare" vjen një rrëfim ndryshe i moderatores, që na tregon për pjesën larg dritave të emisionit, famën dhe të vërtetën e puthjes që shkëmbeu me Feron. E rritur në skenë, Roza pohon se është mësuar me dashamirësinë e njerëzve që kur lëvizte me të ëmën, Ritën. Lajmi se bukuroshja e medias ishte e lidhur me këngëtarin Fero bëri mjaft bujë në rrjetet sociale. Kjo ishte edhe arsyeja pse ajo zgjodhi ta puthte këngëtarin, duke pranuar se kështu do i bëhej qejfi publik. Roza mes të qeshurash na tregon për aventurën në Tailandën dhe se çfarë i thotë vetes kur del para pasqyrës. Së fundmi, Lati thotë se ka lindur për spektakël. Gjaku i artistit trashëgohet dhe mesa duket, ajo do arrijë majat si e ëma, Roza Lati.

Situata më e vështirë gjatë emisionit?

Nuk kam kaluar ndonjëherë situata të vështira gjatë emisionit, sepse nuk më kanë dalë ndonjëherë situatat nga kontrolli. Improvizimi është arma ime më e fortë, kështu që ia dal gjithmonë me sukses sa u përket surprizave që mund të ndodhin goftë për mirë, goftë për keq. Unë emisionin e bëj vërtetë me kënaqësi dhe nuk kam parë kurrë vështirësi.

Çfarë të ngre adrenalinën? Adrenalinën ma ngre Sasha kur sheh ndonjë qenë në rrugë dhe egërsohet. (qesh) Je një nga personazhet më "In" të momentit. Të ka ndryshuar fama?

Unë e kuptoj që njerëzit më njohin në rrugë gradualisht çdo ditë dhe më shumë, por që ndryshimi im mes personazheve të tjerë "In" që janë bërë të famshëm ka të bëjë me faktin se unë jam vajza e aktores, jam vajza e një personazhi publik, që do të thotë se unë famën e kam pasur në shtëpi. Jam rritur me famën. Pesë vjeçe shkoja me mamën për të blerë bukë. Na shkante rruga 20 minuta, sepse e ndalonin për t'i marrë autografe, se atëherë nuk ka pasur selfie dhe jam rritur me idenë se



njerëzit të shohin, të ndalin, të përqafojnë, të duan, të admirojnë, kështu që për mua është shumë normale kjo pjesë. Nuk bën fare asnjë lloj difference, sepse i kuptoj shumë mirë vajzat që nga dje kanë pasur një jetë shumë të thjeshtë, me familje shumë të thjeshtë (quaj këtu familje që nuk kanë lidhje me ekranin dhe papritur futen në botën e televizionit dhe dashje pa dashje u hipën vetja në qejf, se është normale). Unë këtë gjë nuk e shoh fare te vetja, sepse thashë që jam rritur me famën në shtëpi.

Si është më bukur "Roza është vajza e Ritës, apo Rita është mamë i Rozës"?

Gjithmonë unë do jem vajza e Ritës. Mami kur shkon nëpër koncerte ka rastisur shpeshherë që i kanë thënë

"Mami i Rozës, duam të bëjmë një foto me ty, pasi nuk kemi Rozën". Mami tim i është bërë shumë qejfi për këtë gjë. Edhe mua më bëhet qejfi, por Rita është ikonë, është diva dhe mua më duhen 35 vite eksperiencë që të barazohem me të. Madje, me thënë të drejtën, sipas ligjit të fizikës nuk kam për t'u barazuar kurrë, kështu që jam Roza, vajza e Ritës.

Pse nuk të shohim kurrë në shoqërinë e një mashkulli?

Nuk e di motër, ku del ti dhe e pi kafen që s'më ke parë në shoqërinë e një mashkulli, sepse unë jam një vajzë që kam më shumë shoqëri me shokë se sa me shoqe (qesh).

Pse zgjedhe të puthje Feron dhe jo ndonjë të ftuar tjetër?


Zgjedha të puth Feron, sepse atë ma bënë për të dashur. Unë kam përkrahur shumë talente në emisionin tim edhe në këto 7 vite eksperiencë që kam në televizion me emisione të ndryshme që kam bërë. Kam pasur gjithmonë të ftuar artistë të rinj, talente të reja. U kam dhënë gjithmonë suport këtyre të fundit dhe gjithmonë do u jap, po nuk e di pse Feron më bënë për të dashur. Meqë kishte kaq merak publiku Feron, thashë OK po e puth në buzë, po i bëj qejfin publik.

Çfarë duhet të ketë një mashkull që të fitojë vëmendjen tënde?

Një mashkull që të fitojë vëmendjen time duhet të ketë humor, duhet të jetë gentleman, duhet të ketë një buzëqeshje shumë të kurrar me dhembë të pastër, të bukur. I kam shumë merak dhembët dhe buzëqeshjen tek meshkujt dhe mbi të gjitha, një mashkull që të fitojë vëmendjen time duhet të ketë shumë vetëbesim. Femra gjithmonë tërhiqet nga meshkujt me vetëbesim.

Aventura më e rrezikshme që ke kaluar?

Aventura më e rrezikshme që kam kaluar ka qenë me kushërirën time Visanën, në Tailandë, pasi aty ishim dy gricma të vogla në një Sahara gjigande. Nuk njihnim njeri, askush nuk na njihje dhe sado qejf bënim, hapnim sytë majtas-djathtas se mos na rrembenin dhe na vidnin veshkën (qesh). Na kishin trembur këtej nga Shqipëria: "Kujdes se mos u vjedhin!". Kemi pasur vërtet frikë kur vajtëm, por që kur ishim atje kemi pasur një mikpritje fantastike dhe na kanë trajtuar jashtë mase mirë. Ishte rrezik në trurin



tonë, por në aparençë ishte çdo gjë OK, ishte perfekt.

Cili është mendimi i parë që të vjen kur je para pasqyrës?

Mmm. Ktheu Roza, fli gjumë prapë, ke nevojë të flesh gjumë! Ke djegur shumë energji. Roza Lati je një "Benz 6000 AMG", ngele duke djegur. Shko Roza në krevet, fli. Mos u ço Roza!

E ndjen veten gati për të


prezantuar edhe ndonjë spektakël?

Mendoj se do isha perfekt për të prezantuar spektakël, sepse jam shumë e qeshur, shumë solare, kam humor dhe shumë batuta. Jo se jam e përgatitur, por mendoj se kam lindur për spektakël. Kam lindur për skenën, jam rritur në skenë me mamën, kështu që mendoj se është gjenetike.



Metëbrendshme dhe mbi krevat, Dafina Zeqiri feston suksesin e fundit

Ajo është një ndër zërat më të pëlqyer për publikun dhe një këngëtare me stil. Bëhet fjalë për Dafina Zeqirin. Bukuroshja së fundmi ka festuar me një gotë verë dhe me mënyrë mjaft sensuale, një milion ndjekës në "Instagram". Me të brendshme dhe mbi krevat, ku duket shumë seksi, Dafina ka postuar një imazh për të ndarë me fansat e saj këtë sukses. "Gëzuar 1 milion", ka shkruar këngëtarja, ndërkohë që u është bashkuar artiste të tjerë shqiptarë me mbi një milion ndjekës, si Noizy, Ledri, Era Istrefi, Elvana Gjata etj.



Luana paralajmëron fansat, ja çfarë po ndodh me këngëtarën

Luana Vjollca mbetet një nga moderatoret më seksi të ekranit shqiptar. Ajo është mjaft aktive në rrjetet sociale, duke ndarë me fansat gjithçka që ndodh në jetën e saj, larg emisionit. Nuk kishte si të mungonte një postim nga momentet e punës. Këtë herë Luana shfaqet në një studio, ku duket se po punon për këngën e saj të re. E veshur me sportive dhe me një palë çizme të larta, bukuroshja duket tejet në formë.



E kritikuan se puthi vajzën në buzë, zbuloni si reagon Roberti

Ai është kritikuar shumë për puthjen që i dha së bijës në buzë. Robert Berisha ka reaguar ndaj të gjitha fjalëve duke dhënë shpjegimin për gjestin që u zmadhua. "Shyqyr që është vajza ime dhe fati i saj është që nuk e përpiva fare, po kaloi mirë me një puthje. Aq shumë më merr malli për të!". Sa u përket paragjyqimeve, Roberti edhe një mesazh për të gjitha portalet: "Portalet puthin edhe vajzat e të tjerëve dhe nuk u duket e çuditshme. Por, kur shohin fytyra publike që bëjnë një gjest të tillë, atëherë bëjnë një shkrim që të përfitojnë nga klikimet. Gjithsesi, janë shumë të mirë. Unë i dua fort", e mbyll Roberti komentin e tij.



Rikthehet me foto të nxehta, Keisi Meidini më në formë se kurrë

Një tundim i vërtetë është vajza e këngëtarit Sabian. Keisi Meidini iu është rikthyer postimeve të saj të nxehta. "A jam e nxehtë mjaftueshëm për ty?", ku mes të tjerash bukuroshja ka theksuar se ai që merr vëmendjen e saj duhet ta dijë me sa fat është. Natyrisht, që reagimet pas postimit të fotos në "Instagram" kanë qenë të ndryshme. Disa prej komentuesve e akuzojnë Keisin për të pasmet e saj të mëdha, që sipas tyre janë fotoshop. Meidini ka vendosur të mos u kushtojë rëndësi këtyre zërave duke mos reaguar fare ndaj tyre.



BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



SHENDETI
KESHILLA

KESHILLA

7 mënyra për ta zgjidhur
problemin e pagjumësisë

"The Guardian": Nëse nuk ju ndihmojnë këto këshilla, jeni duke vuajtur nga depresioni

Shumë njerëz ankohen se kanë probleme me pagjumësinë. Arsyet e këtij problemi mund të jenë të ndryshme, por këto shtatë ide mund të ju ndihmojnë që ta zgjidhni këtë problem.

Rregullojeni dhomën e gjumit

Dhoma e gjumit është për të fjetur, prandaj mos e përdorni atë si dhomë të ndejës. Është vend i pushimit, prandaj duhet ta mbani të qetë dhe të errët. Trupi i njeriut ka nevojë për errësirë që ta lirojë melatoninin, e cila ju ndihmon të flini. Prandaj, investoni në bllokimin e dritës në dritare. Fikni telefonat celularë dhe ekranin e kompjuterit, pasi drita që vjen nga këto ekrane, e pengon prodhimin e melatoninës. Nëse keni nevojë për një dýshek të ri, sigurohuni që të zgjidhni të duhurin për trupin tuaj.

Respektojeni një orar të njëjtë të gjumit

Nuk duhet të bëni aktivitete ditore, të cilat më vonë e pengojnë gjumin tuaj dhe e vonojnë kohën e fjetjes. Prandaj, anashkaloni gjumin e shkurtër gjatë ditës dhe shkoni për të fjetur përafërsisht në të njëjtën orë çdo natë. Shijojeni rutinën e mbrëmjes duke bërë një dush të ngrohtë, fikni ekranet e pajisjeve elektrike të pak- tën 40 minuta para se të shtrihen për të fjetur, lexoni disa faqe libri ose dëgjoni muzikë të lehtë.

Kujdes me ushqimin dhe pijet

Alkooli mund ta pengojë ciklin tuaj të gjumit. Ai ju ndihmon të flini mirë në fillim, por do të zgjoheni pak orë më vonë. Mënjanoni sasi të mëdha të ushqimit në mbrëmje, sidomos ushqimet e pasura me kalori dhe ushqimet me shije djegëse, të cilat mund të shkaktojnë probleme të barkut. Mos pini kafe pas kohës së drekës. Një studim i vitit të kaluar vërtetoi se kafeina e pakësuar kohën e gjumit dhe e dëmtoi cilësinë e tij.

Mos e shikoni orën

Një arsye tjetër pse mbesim zgjuar gjatë natës është për shkak të stresit rreth faktit që ende jemi zgjuar. Prandaj, përpiguni të mos e shikoni orën sepse kjo mund t'ju bëjë të ndiheni në ankth. Në vend të kësaj, mundohuni ta paramendoni veten në një vend të rehatshëm, të ngrohtë dhe të sigurt. Mendoni për kujtimet e bukura dhe bindeni veten se edhe të nesërmen do të kaloni mirë.

Nëse vërtet nuk ju merr gjumi, ngrihuni

Nëse shpesh shtriheni dhe qëndroni zgjuar për më tepër se gjysmë ore, qoftë kur për se pari herë shkoni në shtrat apo më vonë gjatë natës, ngrihuni dhe rehatohuni në një vend tjetër dhe lexoni ndonjë libër ose dëgjoni pak muzikë. Kthe-



huni në shtrat kur të ndiheni të lodhur. Kjo do t'ju ndihmojë që shtratin ta shihni si vend të gjumit dhe jo vend të qëndrimit zgjuar.

Shkarkojeni aplikacionin "Sleepio App"

I qasshëm për banorët që kanë qasje në "NHS", ky aplikacion është një program digjital i bazuar në terapinë e sjelljes, i cili ju ndihmon të zbuloni mënyrën më të mirë personale për të fjetur. I dizajnuar për ta zvogëluar varësinë nga barnat për gjumë, një studim ka treguar se ky aplikacion ju ka ndihmuar më tepër se 75% të njerëzve me probleme të pagjumësisë që ta arrijnë sasinë normale të gjumit.

**Mbajeni një ditar gjumi**

Regjistroni sasinë e gjumit brenda një periudhe dyjavore. Llogariteni se sa kohë ju nevojitet të flini kur shkoni në shtrat dhe nëse zgjoheni ndonjëherë natën apo jo. Shikoni nëse mund ta ndryshoni ndonjë shprehje. Për shembull, ndoshta ju flini më së miri kur bëni ushtrime fizike. Ditari i gjumit po ashtu mund ta ndihmojë mjekun që ta gjejë problemin e pagjumësisë. Nëse nuk ju ndihmojnë këto këshilla, ju mund të jeni duke vuajtur nga depresioni, pasi pagjumësia është një shenjë fillestare e tij, shkruan "The Guardian".

Ndërsa gërmuan një nga piramidat egjiptiane, arkeologët zbuluan disa kavanoza me mjaltë 2.000-3.000 vjet e vjetër

KESHILLA TË VLEFSHME:

Ka disa ushqime të cilave nuk u kalon afati, mësoni cilat janë

Përdorimi i produkteve me afat të skaduar mund të jetë i rrezikshëm, por ka disa ushqime për të cilat asnjëherë nuk duhet të shqetësoheni, sepse janë të sigurta për t'u ngrënë edhe pas shumë vjetësh. Më poshtë ju sjell listën e këtyre ushqimeve, për të cilat ekspertët thonë se asnjëherë nuk iu skadon afati.

ORIZI

Temperatura më e mirë për të ruajtur orizin është në 4.5°C ose më pak. Orizi është mirë të ruhet në enë plastike për ushqime (PETE) ose në kavanoza qelqi. Siç tregojnë një studim, në këto kushte, orizi mund të ruhet deri në 30 vjet dhe nuk do të humbasë aromën ose vlerën ushqyese.

QUMËSHI PLUHUR

Qumështi i pluhur që përpunohet në përpunues me të gjitha standardet e duhura shëndetësore mund të ruhet për një kohë të gjatë pa humbur vlerën e tij ushqyese për aq kohë sa ruhet në një enë hermetike.

SALCA E SOJËS

Salca e sojës mund të ruhet në mënyrë të sigurt për të paktën 3 vjet edhe në qoftë se shishja është e hapur. Salca sojëse duhet të ruhet në një enë hermetike, por varet nga kushtet si lloji i salcës së sojeve, mënyra e përpunimit, cilësia e tij dhe temperatura e ruajtjes.

Për shembull, salcë soje me cilësi të lartë mund të bëhet vetëm përmes fermentimit natyror, një proces që zakonisht merr diku nga disa muaj deri në dy vjet. Vetëm ky lloj soje mund të zgjasë më shumë se tre vjet. Kjo është arsyeja pse ju duhet të keni kujdes nga disa marka që shtojnë kimikate për të përsheptuar procesin e fermentimit.

KRIPA

Kripë është në të vërtetë një mineral, jo një produkt, prandaj është e pamundur që ajo të priset. Natyrisht, minerali mund të thithë shpejt ujë, duke u kthyer në një shkëmb të madh me kalimin e kohës. Por në fund të fundit, kripa gjithmonë mbetet vetëm, kripë. Megjithatë, mos harroni se kripë iodizuar zgjat vetëm rreth një vit. Gjatë kësaj periudhe, jodi zakonisht avullohet dhe kripërat e humbin cilësinë e dobishme, edhe pse ju mund ta përdorni atë si kripë të zakonshme të tryezës.

PIJET E FORTA ALKOOLIKE

Pijet alkooolike si vodka, uis-

ki, rumi dhe konjaku nuk kanë një datë të skadimit, por është e rëndësishme t'i ruani ato në një vend të freskët të errët në shishe të mbyllura siç duhet.

UTHULLA

Uthulla e bardhë është një tjetër produkt pa një afat të skadimit, por ju duhet të jeni të sigurt për ta ruajtur atë në kushte të përshtatshme. Nëse doni të mbani uthull për një kohë të gjatë, mënyra më e mirë për të ruajtur është në shishen origjinale të tij hermetik në një vend të ftohtë dhe të errët larg burimeve të nxehtësisë.

SHEQERI

Si kripa, sheqeri zgjat për një kohë të pacaktuar kohë të gjatë, veçanërisht në qoftë se ju ruani atë në një enë hermetike. Por edhe nëse sheqeri thith ujë nga ajri dhe kthehet në një shkëmb të ngurtë, ai nuk humbet cilësinë e tij. Sheqeri pluhur dhe sheqeri kaf gjithashtu mund të ruhen për aq kohë sa sheqeri të përbashkët.

MJALTI

Mjalti është një ushqim me të vërtetë unik në atë që mund të zgjasë përgjithmonë në sajë të përbërjes kimike që e bën jashtëzakonisht të veshtritur për rritjen e bakteve. Për më tepër, nëse blihen kavanoza të mbyllura me mjaltë në to, mund të jeni absolutisht i sigurt se nuk mund të prishin, pasi nuk do të vihet në kontakt me ajrin dhe tujin.



Perëndimi i kërkon ministrin serb të ndalë lobimin kundër kosovarëve

Dialogu me Serbinë, kancelari austriak viziton Kosovën

Sebastian Kurz takohet me Vuçiç në Beograd

Pas një vizite në Serbi ditën e djeshme, kançeleri austriak në Kosovë do të zhvillojë edhe disa takime me udhëheqësit e Kosovës, përgjatë ditës së martë. Ai pritet të takohet me presidentin e vendit, Hashim Thaçi, si dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Sipas APA temat të cilat do të diskutohen në këto takime janë: Çështja e dialogut Kosovë-Serbi, perspektiva evropiane e Kosovës si dhe çështja e formimit të Ushtrisë së Kosovës. Po ashtu, gjatë qëndrimit të tij në Kosovë do të zhvillojë takime edhe me ushtarët austriakë të KFOR-it. Në njoftimin e kabinetit qeveritar të kryeministrit të Austrisë u tha se ai gjatë vizitës në Serbi dhe Kosovë do t'i japë mbështetje procesit të afërimit të vendeve të Ballkanit me BE-në dhe të inkurajojë perspektivën euroatlantike të këtyre vendeve, duke inkurajuar edhe vazhdimin e dialogut në mes Prishtinës dhe Beogradit. "Arrija e një marrëveshjeje përmes dialogut mes Serbisë dhe Kosovës, është kusht për anëtarësimin e plotë të dy vendeve në BE", thuhet në njoftimin e qeverisë austriake. Bashkimi Evropian do të jetë i plotë vetëm pasi të jenë anëtarësuar edhe vendet e Ballkanit Perëndimor", thuhet në raportimin e APA-s. Kançeleri i Austrisë, Sebastian Kurz është pritur dje në Beograd nga Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Sipas mediave vendase temat kryesore për të cilat kanë biseduar Kurz dhe Vuçiç kanë qenë marrëdhëniet bilaterale, dialogu mes Prishtinës dhe



Sebastian Kurz, kancelari austriak

IVICA DAÇIÇ

"Vendet perëndimore po i kërkojnë Serbisë të pezullojë një fushatë diplomatike që po arrin të ndikojë në shtetet që e kanë njohur Kosovën. Pala kosovare është ankuar te perëndimorët për mua dhe Perëndimi kërkon që ta ndalojë fushatën në mënyrë që t'i lejojë ata të llobojnë për njohje të reja dhe të anëtarësohen në organizata ndërkombëtare", - ka deklaruar Daçiç.

Beogradit si dhe pranimi i Serbisë në BE. Kurz pas takimit me Vuçiç do të takohet edhe me kryeministren serbe, Ana Bërnabiç. "Vendet perëndimore po i kërkojnë Serbisë të pezullojë një fushatë diplomatike që po arrin të ndikojë në shtetet që e kanë njohur

Kosovën". Kështu ka deklaruar për 'Novosti', ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç duke theksuar se për këtë është ankuar pala kosovare. "Pala kosovare është ankuar te perëndimorët për mua dhe Perëndimi kërkon që ta ndalojë fushatën në mënyrë që t'i le-

jojë ata të llobojnë për njohje të reja dhe të anëtarësohen në organizata ndërkombëtare", ka deklaruar Daçiç. Ministri serb, i cili po supozon se shtete të ndryshme po e shqyrtojnë edhe një herë njohjen e Kosovës si shtet ka thënë se ky është një rezultat i madh i Serbisë, i cili e faktin se Kosova nuk është çështje e zgjidhur. "Edhe kur të votohet për anëtarësimin e tyre në Interpol do të kuptohet se kjo çështje nuk është zgjidhur dhe se Prishtina ka një listë të rreme me numrin e vendeve që e kanë njohur Kosovën. Mund të garantojë se pranimi në Interpol nuk do të ndodhë". Siç thek-

QEVERIA AUSTRIAKE

"Arrija e një marrëveshjeje përmes dialogut mes Serbisë dhe Kosovës është kusht për anëtarësimin e plotë të dy vendeve në BE", thuhet në njoftimin e qeverisë austriake.

son gazeta, qëllimi i Serbisë është që numri i vendeve që e kanë njohur Kosovën të bie nën 100 deri në fund të këtij viti. Për lobimin e Serbisë kundër Kosovës ka reaguar Ministria e Punëve të Jashtme, e cila ka kërkuar nga Bashkimi Evropian t'ia tërheq vërtetjen shtetit fqinj. "Ministria e Punëve të Jashtme i vlerëson të papranueshme veprimet destruktive, qasjen dashakeqëse dhe standardet e dyfishta, që shteti fqinj Serbia po i përdorë në marrëdhëniet me shtetet njohëse dhe jo-njohëse të Republikës së Kosovës duke shfrytëzuar, keqpërdorur dhe manipuluar me dialogun për normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes dy shteteve me qëllimin parësor për të bërë agresion diplomatik kundrejt sovranitetit dhe imazhit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës", është thënë dje në reagimin e MPJ-së.

SHKURT

Gjyqi për El Capon, masa të rrepta sigurie për lordin e drogës

Të hënë e ardhshme në New York do të mbahet gjyqi ndaj lordit meksikan të drogës, Joaquin Guzman, i njohur me emrin El Chapo. Autoritetet kanë shtuar masat e sigurisë, ndërsa kanë mbajtur të fshehtë emrat e 12 anëtarëve të jurisë. El Chapo ishte ekstraduar nga Meksika dhe mbahej i burgosur në një qeli, në burgun federal të New York-ut. Akuzat ndaj Guzman janë të shumta, duke filluar që nga trafikimi i sasive të mëdha të drogës në Amerikën e Veriut, pastrimi i parave dhe rrëmbimet. El Chapo akuzohet, gjithashtu, për disa vrasje në qytetet e Chicagos, Miamit dhe New York-ut. Sipas 'Zërit të Amerikës', hetuesit do të kërkojnë sekuestrimin e 14 miliardë dollarëve nga pasuria e lordit të drogës. Ndërkohe masat e sigurisë për gjyqin ndaj Guzman janë shtuar së tepërmi, duke marrë shkas nga dy arratisjet e tij nga burgjet e sigurisë së lartë në Meksikë. Për sa i përket dëshmitarëve, ata po mbahen në mbikëqyrje të rreptë, për të parandaluar ndonjë atentat nga anëtarët e tjerë të kartelit Sinaloa.

Britani, humbin jetën në aksident 3 anëtarë e një familjeje

Tre anëtarë të një familjeje humbën tragjikisht jetën në një aksident me makinë. Ngjarja e rëndë ndodhi orët e para të së dielës në Alderley Edge, Cheshire të Britanisë së Madhe. Viktimat, një burrë 47-vjeç, grua 41-vjeçe dhe një vajzë 14-vjeçe udhëtonin me makinë, kur u përplasën me një minibus. Dy personat të tjerë që ndodheshin në minibus, një vajzë 9-vjeçare dhe një 19-vjeçare u dërguan në spital dhe sipas të përditshmes "Mirror", janë në gjendje të rëndë për jetën. Shumë prej pasagjerëve që ndodheshin në minibus morën ndihmën e parë në vendngjarje dhe më pas u dërgua në spital. Ndërkohë, policia tha se 47-vjeçari dhe 14-vjeçarja gjeten vdekjen në vend, ndërsa grua vajdi në spital. Mbeten të pagarta rrethanat e këtij aksidenti të rëndë.

Meksikë, dasmorët përshëndesin për herë të fundit çiftin

Një çift i sapo martuar gjeti tragjikisht vdekjen pak orë pas ceremonisë martesore, pasi helikopteri në të cilin ndodheshin u përplas në një kodër në Teksas. Will Byler dhe Baile Ackerman, të dy studentë në Sam Houston State University, në Huntsville, gjeten vdekjen së bashku me pilotin orët e para të së dielës. Vetëm 90 minuta përpara aksidentit, të futurit i kishin përshëndetur dhe i kishin parë të largoheshin me helikopterin e familjes, pas dasmës së tyre përallori. Shkaku i rrezimit të helikopterit nuk dihet ende. Për ngjarjen e rëndë autoritetet kanë nisur hetimet.

Zvicër/ Përfitoi 420 mijë franga 'gratis', burgoset shqiptari

Mashtroi për invaliditet për 10 vite, gjykata zbaton referendumin e 25 nëntorit

Në kohën kur Zvicra për gatit të votojë në referendumin mbi survejimin e personave të dyshuar për keqpërdorim, një përkrahje e madhe vjen nga vendimi i gjykatës zvicerane, që ka rikonfirmuar dënimin e një shqiptar Referendumi i 25 nëntorit konkretisht bën fjalë për vëzhgimin e fshehtë në shtëpitë e disa përfituesve të pensionit invalidor, por që, në fakt, shteti ka dyshime se ai shtetësi i tillë vetëm për të mos punuar dhe fituar shuma të majme. Një shembull është 47-vjeçari kosovar, i cili kishte përfutur për rreth dhjetë vjet pa të drejtë pensionin invalidor ose më konkretisht i ka sjellë 420 mijë franga dëme buxhetit zviceran.

SI NISI HISTORIA
Burri nga Kosova pësoi aksident në 2000 në Zürich-Altstetten. Më pas ai u ankuar për dhimbje koke dhe shpine, nervozitet dhe agresivitet. Gjendja e tij shëndetësore sa vinte e përkeqësohej, dhe siç kishte shtuar gruaja e tij përpara mjekëve, burri i saj ishte izoluar në tërësisht dhe përkujdesej sikur të ishte një fëmijë. Burri u shpall 100 për qind i paafët për punë dhe fitoi pensionin. Përveç kësaj, dy komnatat e tij rezidenciale i paguan atij shërbime shtesë në aglomeratin e Cynrit.
AKUZAT FILLUAN NGA 2008
Në tetor 2008 një person



anonim është paraqitur në Zyrrën për përfitimim e pensionit invalidor dhe ka treguar se burri nga Kosova prej pesë vjetësh punonte në të "zezë" si bodyguard/roje

në një diskotekë. Zyra invalidore vendosi një detektiv privat për të vëzhguar privatisht 47-vjeçarin. Aty u zbulua se ai shkonte rregullisht në pushime në Kosovë, voziste vetura luksoze, kishte vizituar rivierën egjiptiane dhe turke, kurse në vendlindje kishte ndihmuar një të afërm për të ndërthurur një shtëpi. Përfituesi e ndihmave kishte qenë edhe bashkëshortja e tij. Së bashku, edhe pse përfitues të ndihmave invalidore, ata udhëtonin me X5. Për t'u shpallur i pajafshëm, shqiptari theksoi se momentalisht trajtohet të 13 mjekë dhe se pi 13 tableta në ditë. Avokati i tij, gjithashtu,

e mbron, duke thënë se 'ai është tërësisht i paafët për punë'. Por, pasi prokuroria kërkoj 41 muaj heqje lirie, Gjykata Rajonale e Zvicrës e dënoi në dhjetor 2016 për shkak të mashtrimeve me 36 muaj heqje lirie - prej të cilave 12 duhet me patjetër. Shqiptari e dërgoi çështjen deri te Gjykata e Lartë, e cila u zhvillua të enjten. Kjo përkundër çështjes tepër të vjetër - prej përpara më shumë dhjetë vjetësh. Gjykata është e bindur se 47-vjeçari ka qenë tërësisht i shëndetshëm, duke keqpërdorur fondin invalidor. Gjykatësi pranoi se ai nuk ka qenë një-qindërqind i aftë për punë, por ai është shtirë më tepër se ç' duhet. Dhe, në fund, gjykatat zvicerane u shpreh ndaj shqiptarit: "Me vërimin tuaj, kemi mundësuar reklamën më të mirë për referendumin e 25 nëntorit."

'Kaçifas', eurodeputetja greke: Detyrim moral të hap çështjen në KE

Theocharous: Shkelën të drejtat e minoritarëve. Mund të arrestohet, por e ekzekutuan

Eleni Theocharous, eurodeputetja qipriote, e konsideroi detyrim moral të ngrejë çështjen 'Kaçifas' si dhe të shkeljes sipas saj të të drejtave të minoritarëve të zonës në Shqipëri. "Kaçifas mund të arrestohet, por u ekzekutua nga policia shqiptare"-ka thënë eurodeputetja për mediat greke. Për kryeministrin Rama dhe deklaratat e tij, eurodeputetja Theocharous deklaroi se si me qipriotin S. Solomu, le të

ELENI THEOCHAROUS

"Qipriotin S. Solomu le të jetë kryeministri i korrupsionit, që e konsideron 'ekstremist të marrë' e jo Athina Kostandinos Kaçifën. Kam detyrim moral të hap çështjen e shkeljes së të drejtave dhe vrasjes së Kaçifas në Parlamentin Evropian", - ka thënë Theocharous.

jetë kryeministri i korrupsionit që e konsideron "ekstremist të marrë" e jo Athina Kostandinos Kaçifën. "Kam detyrim moral të hap

çështjen e shkeljes së të drejtave dhe vrasjes së Kaçifas në Parlamentin Evropian". ka thënë ajo. Kujtojmë se edhe më herët

eurodeputetja greke ka thënë se vrasja e Kaçifas do t'i hapë probleme Shqipërisë me anëtarësimin në BE. Ndërkaq kujtojmë se ngjarja ka ndodhur në Bularat të Gjirokastrës javën e kaluar. Çështja e vrasjes së ekstremistit grek, minoritarit Konstantinos Kaçifas në Bularat duket se do të vazhdojë gjatë të qëndrojnë si temë debati mes Shqipërisë dhe Greqisë. Burime diplomatike konfirmojnë informimin e ekipit



Eurodeputetja greke, Eleni Theocharous

policor grek dhe në Tiranë për rrethanat e ngjarjes dhe hetimin paraprak, në pritje të vendimit të prokurorisë së Tiranës, ku duhet të përfshihen dhe provat. Në fazën e parë, pala shqiptare ka përshkruar ngjarjen dhe reagimin e policisë shqiptare. Ekipi grek do qën-

drojë në Tiranë deri në mbyllje të hetimit. Diplomacia greke konsideron se kërkesa e familjes për dorëzimin e trupit duhet pranuar menjëherë pasi nuk ndikon në asnjë drejtim drejtësinë vendore, theksojnë burime të sigurta në Greqi

Turqia 'shpërthen' ndaj grekëve për shfrytëzimin e resurseve nënujore pa leje

Vijon sërish 'lufta e ftohtë' mes Greqisë dhe Turqisë. Së fundmi ka ndodhur një tjetër përplasje në distancë mes Ankarasë dhe Athinës për zonat ekskluzive ekonomike. Nga Stambolli ku mori pjesë në ceremoninë e dorëzimit të një luftanije dhe një nëndetëseje të re për flotën detare, presidenti turk Rexhep Taip Erdogan paralajmëroi reagim të ashpër për këdo që shfrytëzon resurset nënujore pa marrëveshje me Turqinë dhe Qipron turke. "Nuk ia kemi vënë syrin të drejtave, ligjeve e territoreve të vendeve të tjera. Mbrojmë vetëm të drejtat tona dhe të vëllezërve tanë. Ata që menduan se mund të ndërmerren hapa në Mesdheun lindor dhe Egje kanë nisur ta kuptojnë efektin e gabimeve të tyre. Nuk do të lejojmë banditët e detit të bredhin lirshëm, siç bëjnë të paguanin terroristët në Siri". Ministri grek i Mbrojtjes, Panos Kamenos e krahasoi sjelljen e Turqisë me "piratët detarë" dhe bëri edhe një paralajmërim për Erdoganin. "Të gjithë e dimë, cilët janë piratët e Egjeut. Greqia nuk po provokon askënd, por as nuk do të lëshojë asnjë centimetër nga e drejta e garantuar nga ligjet dhe traktatet ndërkombëtare. Kufijtë e Greqisë janë edhe të Bashkimit Europian, ndaj dhe dhunimi i tyre është dhunim i kufijve të BE-së". Prej dekadash, Turqia dhe Greqia kanë mosmarrëveshje për shfrytëzimin e resurseve nënujore. Greqia nuk e njeh Republikën turkoqipriote të shpallur nga Ankaraja në vitet '60 dhe shtrin kërkimet për naftë dhe gaz në hapësirën detare të ishullit, duke e konsideruar si territor grek. Ndërkaq jo më larg se fund i muajit të kaluar ka pasur një tjetër përplasje politike mes dy shteteve. Deklaratat politike të qeverisë greke dhe kundërpërgjigja turke janë përkthyer me lëvizje intensive të anijeve luftarakë në Egje në pritje të urdhrave për të vepruar. Kryeministri Tsipras nga pozicioni i Ministrit të Jashtëm ka publikuar një dek-

Erdogan paralajmëron Greqinë: Do paguani si terroristët në Siri

Kamenos: Nëse ndërhyini, do dhunoni kufijtë e BE-së



Presidenti Turk, Rexhep Taip Erdogan

PANOS KAMENOS

"Të gjithë e dimë cilët janë piratët e Egjeut. Greqia nuk po provokon askënd. Kufijtë e Greqisë janë edhe të Bashkimit Europian, ndaj dhe dhunimi i tyre është dhunim i kufijve të BE-së", - ka thënë ministri grek.

laratë zyrtare ku thuhet se Greqia ka të drejtë në bazë të ligjit ndërkombëtar që të zgjerohet hapësirën e saj detare me 12 milje. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme greke, Alexandros Gennimatas, tha se zgjerimi i ujërave territoriale të Greqisë bazohet në ligjet ndërkombëtare. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme turke Hami Aksoy iu përgjigj homologut grek me faktin se Asambleja e Madhe Turke në deklaratën e votuar më 8 qershor 1995 ka sanksionuar se nëse Greqia zgjeron ujërat territoriale në detin Egje, përtej gjashtë miljeve, parlamenti turk do t'i japë qeverisë "të gjitha

kompetencat", duke përfshirë fuqitë ushtarake, për të mbrojtur interesat e Turqisë. Turqia dërgoi anijen e shpim kërkimit Hayreddin Pasa dhe dy fregata ushtarake në Mesdheun lindor në një zonë që përfshin një segment të shefit kontinental të Greqisë për të eksploruar gazin natyror: Hayreddin Pasa u detyruar të tërhiqej pasi marina greke lëshoi një paralajmërim për radio. Gjiganti i naftës së SHBA Exxon-Mobil do të eksplorojë gjithashtu për gazin natyror në zonë këtë vjeshtë, një vendim që mund të intensifikojë më tej tensionet midis Uashingtonit, Ankarasë dhe Athinës.

Ndërron jetë aktivistja ukrainase pas 11 operacioneve


Ka ndërruar jetë 3 muaj pasi u sulmua me acid një aktiviste e njohur e lëvizjes anti-korrupsion në Ukrainë. Katerina Handzyuk, 33 vjeç, pësoi djegie në mbi 40% të trupit të saj, ndërsa pati dëmtime edhe në sy. Për këtë arsye ajo u detyrua t'i nënshtrohej 11 operacioneve. Sulmi ndaj aktivistes u dënua edhe nga presidenti Petro

Poroshenko, i cili në një dalje për mediat ditën e djeshme, kërkoi ndëshkimin e autorëve. Sipas BBC, deri në këtë moment janë arrestuar 5 persona, si të dyshuarit kryesorë për sulmin. Sipas të dhënave, shkaku i vërtetë për vdekjen e 33-vjeçares është bërë mpiksjka e gjakut. "E di që dukem keq tani, por të paktën po kurohem. Jam e sigurt se përsëri

dukem shumë më mirë sesa drejtësia në Ukrainë, pasi askush nuk po vë dorë që ta ndryshojë situatën", - u shpreh Handzyuk teksa kurohej në spital. Katerina Handzyuk u sulmua më 31 Korrik në qytetin jugor Kherson. Vdekja e 33-vjeçares shkaktoi reagime të shumta në rrjetet sociale, ku mjaft mbështetës të saj mbetën të shokuar.

Kapet vrasësi i futbollistit: Tentoi të më përdhunonte gruan

Një ngjarje e rëndë e ndodhur në fund të tetorit duket se po zbardhet përmes detajeve më të fundit që janë bërë publike. Bëhet fjalë për vrasjen e futbollistit të Sao Paulo në Brazil, Daniel Correa Freitas, i cili u gjet i vdekur në një shturrë më 27 tetor. Atij i ishte prerë fyti dhe organet gjentile. Tri ditë më vonë, policia braziliane arrestoi biznesmenin 38-vjeçar Edson Brittes Junior si person të dyshuar për vrasjen e futbollistit. Ai pranoi se kishte vrarë 24-vjeçarin, sikurse thotë vet "në një moment zemërimi", pasi e kishte kapur duke u përpjekur të



përdhunonte gruan e tij Cristiana. Daniel ishte ftuar në festën e ditëlindjes së vajzës së çiftit. Hetuesit nuk janë të sigurtë nëse futbollisti 24-vjeçar ka pasur aferë seksuale me bashkëshortin e biznesmenit të arrestuar për vrasje.

Biznesmeni i tha policisë futbollisti kishte shkelmuar derën e dhomës pasi ishte mbyllur. Më pas kishte dëgjuar të bërtiturat e gruas së tij dhe shkoi menjëherë aty, duke larguar 24-vjeçarin nga krevati për të cilin dyshoi se po tentonte t'i përdhunonte gruan. Më pas shtoi se kishte nxjerrë një thikë nga xhepi, me të cilin kishte vrarë futbollistin. Policia ka arrestuar edhe gruan e vajzës së vrasësit, me akuzën se ishin përpjekur të bindnin dëshmitarët që të mblulonin vrasjen e kryer. Tre të dyshuar të tjerë që mendohet se kanë marrë pjesë në vrasjen e futbollistit janë shpallur në kërkim.

DEBATI



Artan Fuga

DALLIMI I DY PLATFORMAVE

Dallimi mes dy platformave sot, është që kjo bëhet me mekanizma ligjore sipas standardeve të Europës dhe ajo që propozohet nga Fuga është standard shqiptar i ekeperimentuar në 2007 dhe i dështuar. Këtu jemi të papajtuësëm, pjesa tjetër do të reflektohet në një tekst final, ku të tëra janë të reflektueshme vetëm me 2-3 rregullime se pjesa tjetër është e integrueshme. Ai nuk e ka të qartë ku ndahet nga statuti nga ligji, nga rregulloret e me radhë" përfundoi Gjinushi.



Skënder Gjinushi

REFORMA NË AKADEMI

Fuga e Gjinushi, dy orë përplasje me tone të larta për platformat

Fatmira Nikolli

Ashtë rikthyer pas një viti përplasjes mes qeverisë dhe akademikëve reforma në pikën zero? Sot Akademia e Shkencave nuk ka kryetar, menaxhohet nga sekretari shkencor, ndërsa prej shtatorit të 2017-ës, kryeministri ka kërkuar duke e nisur me kërcënim për heqje financimi një Akademi Shkencash funksionale përmes një reforme që diskutohet prej 14 muajsh. Akademiku Artan Fuga që në gushtin e 2017-ës kundërshtoi ofertat dhe modelet, duke i argumentuar qëndrimet e tij. Dje për dy orë, në një takim të asamblesë së Akademisë, ku gazetarët nuk qenë lajmëruar, debati me akademikut Artan Fuga dhe Skënder Gjinushit si kryetar i grupit të reformës dëgjohej jashtë dyerve të sallës. "Ke dështuar reformën" buçiste zëri i Fugës në orën 14:00, teksa frazati e tjera vinin të paqarta. Pas daljes nga mbledhja secili dha versionin e tij mbi platformën e reformës, por pa gjetur një pikë të përbashkët mbi përfundimin.

ARTAN FUGA

I pari doli para mediave Artan Fuga i cili tha se ishte një mbledhje, që e kishte kërkuar grupi i punës i ngritur nga Ministria e Arsimit dhe Akademia e Shkencave për reformën në akademi. "Një mbledhje e asamblesë për të diskutuar, pasi zoti kryeministër ka thënë, që asnjëra nga platformat nuk duhet injoruar. Platforma ime nuk duhet injoruar, por duhet marrë në konsideratë për t'u ballafaquar. Pozicioni im është që platforma e grupit të punës së ngritur nga Ministria e Arsimit, nuk sjell reformim dhe e kalbëzon më rëndë Akademinë. Është rripodhim, nuk ka kon-

cepte të reja, është model që do ta degradojë më keq", tha ai. Profesori shtoi se është i hapur për gjithëpërfshirje që të debatohen të gjitha platformat. "Asambleja pasi ka bërë gjithë censurën e platformës sime, është rikthyer dhe do ballafaqim, siç kam kërkuar unë. Ju keni dëgjuar zëra e tone të forta, se unë pa qenë i lajmëruar për sot dhe pa pasur as dokumente me vete, më kërkoni që këtë ballafaqim ta bënim sot. Ndërsa unë kam kërkuar dy ditë kohë të përgatitem", tha ai.

Fuga shtoi se Skënder Gjinushi, kryetar i grupit të punës, pretendon se këto dy platforma nuk kanë ndonjë dallim dhe mund të jenë të integrueshme. "Kurse mendimi im është që ato dy platforma janë dy modele diemant-tralisht të kundërt, që i japin dy forma edhe dy përmbajtje të ndryshme akademisë. Unë jam i hapur për të diskutuar, por që kjo të bëhet edhe në prani të ministres së Arsimit, e cila në dijeninë time, e pranon që të na thërrasë në zyrë edhe përpara saj ne të bëjmë debat. Nëse gjenden pika të përbashkëta le të bëhen, nëse këto pika nuk bëhen unë mendoj se këtë çështje nuk mund që ta zgjidhim me anë të votës, por do ta zgjidhim duke i cuar të dy platformat në një diskutim, në një juri të madhe, e cila të formohet nga komuniteti i shkencëtarëve, profesorëve edhe universitarëve në vend, që të thonë se cila nga platformat u duket më e përshtatshme", vërejtë Fuga. Ai theksoi se unë jam gati të diskutojmë, pavarësisht se ata përballesh meje, janë gati të diskutojnë, por nuk do të ndryshojnë qëndrim. "Platforma ime jep mundësi reformimi të plotë, ndërsa e tyre është fasadë", përfundoi ai.

SKËNDER GJINUSHI

Para mediave, Skënder Gjinushi sqaroi se ka 2 projektligje,

Fuga: Platforma juaj kalbëzon Akademinë Gjinushi: Reforma e Fugës është rikthim te 2007-a

një për Akademinë e një për Kodin e Etikës, të cilët janë mbështetur ndërkombëtarisht edhe nga grupet e interesit, edhe nga ministritë përkatëse dhe janë të gatshëm për votim. "Meqë Artan Fuga nuk ishte dakord, kryeministri këshilloi e rekomandoi që të shihej edhe njëherë nëse kishte elementë për të marrë nga platforma e Fugës. Kontradikta deri dje nuk ka pasur, por ka pasur në deklarata që unë nuk i

kam kuptuar asnjëherë, sepse pretenduesi asnjëherë nuk ka ballafaquar projektin e vet me projektin tonë. Kjo, pa hyrë në atë që vetëm një individ është kundër Akademisë dhe akademikëve europianë dhe akademikëve të tjerë, grupeve të interesit po ashtu", u shpreh Gjinushi. Ai shtoi se projekti i ri i Fugës, është rikthim te 2007-a. "Këtu është ndarja jonë, sepse është ajo reformë që Fuga me të tjerë kanë kritikuar dhe


Fugës dhe nuk i ka varianti ynë", shtoi Gjinushi. Ai argumentoi se projekti i tij (Fugës) nuk është as sot në formën e projektligjit, është i pavotueshëm, teknikisht është një gjysëm katrohure. "Në përmbajtje ka mbi 70% që janë elementë të statutit dhe janë të parashikuar të vihen në statut e në aktet nënligjore, por nuk mund të jenë pjesë e ligjit. Ligjet synojnë të rregullojnë sa më mirë pranimet në Akademi, së dyti kërkojnë të harmonizojnë më mirë brezat në akademi. Pa bërë ligje e klauzola si në 2007-ën që të vjetrit nuk mund të votojnë, apo të anatohen. Ju e dini që Ismail Kadare nuk mund të votojë? Ia hoqën të drejtën më pas, e është ndarje që nuk i bën asnjë akademi në botë", tha Gjinushi. Sips tij, tjetër është ligji që as akademikët nuk janë të paprekshëm nëse kanë hyrë me plagjiaturë apo me falsitete. "Ligji synon që Akademia të jetë sa më e hapur ndaj jo anëtarëve dhe ndaj akademikëve së të rinjve, po nuk përjashton as të vjetrit. Dallimi mes dy platformave sot, është që kjo bëhet me mekanizma ligjore sipas standardeve të Europës dhe ajo që propozohet nga Fuga është standard shqiptar i ekeperimentuar në 2007 dhe i dështuar. Këtu jemi të papajtuësëm, pjesa tjetër do të reflektohet në një tekst final, ku të tëra janë të reflektueshme vetëm me 2-3 rregullime se pjesa tjetër është e integrueshme. Ai nuk e ka të qartë ku ndahet nga statuti nga ligji, nga rregulloret e me radhë" përfundoi Gjinushi.

Ai vërejtë se projekti i grupit të punës ka marrë mbështetje nga Akademike Europiane dhe se Fuga në 7 muaj nuk ka gjetur mbështetje e askut dhe se është i vetmi kundërshtar për platformën.

Por, teksa Fuga pret ballafaqim, për Gjinushin çdo gjë ka përfunduar. Vijimi për këtë të fundit është teksti final.

KADARE

"Në përmbajtje ka mbi 70% që janë elementë të statutit dhe janë të parashikuar të vihen në statut e në aktet nënligjore, por nuk mund të jenë pjesë e ligjit. Ligjet synojnë të rregullojnë sa më mirë pranimet në Akademi, së dyti kërkojnë të harmonizojnë më mirë brezat në Akademi. Pa bërë ligje e klauzola si në 2007-ën që të vjetrit nuk mund të votojnë, apo të anatohen. Ju e dini që Ismail Kadare nuk mund të votojë? Ia hoqën të drejtën më pas, e është ndarje që nuk i bën asnjë akademi në botë", -tha



ndaj kërkuar të reformohet prapë akademia. Ajo e 2007-ës nuk ka funksionuar, është dënuar dhe është parë si një akademi me ndërhyrje politike. Ajo është si të shotosh një nen, që sa herë ndërrohen mazhorancat të rithemelohet akademia. Kjo çon absolutisht edhe që të rinjtë akademikë, zgjidhen jo me procedura ligjore, por me komisione qeveritare. Këtu ndahemi: dhe kjo ndarje ka filluar me variantin e ri. Asambleja mbështeti faktin që, nëse hiqet kjo që është rikthim pas, pjesa tjetër është përshtatshme, dhe nuk ka asgjë që e ka varianti i

PREMIERA

“DELEGACIONI”

Festivali i filmit si shpurë (ofertë) e pakërkuar e kryeministrit

Fatmira Nikolli

Të dielën në mbrëmje në orën 20:00 në Kinema Millennium u shfaq premiera shqiptare filmit "Delegacioni" të Bujar Alimanit, fitues i "Grand Prix" në kinema Millennium. Filmi shfaqet në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë TIFF. Të shtunën në drekë, zëdhënësja e festivalit, Genta Ramadani, përmes një grupi në 'Whatsapp', ju shkruan gazetarëve: "Me këtë rast po ju njoftoj që nesër në ora 20:00 shfaqet premierë filmi 'Delegacioni', nga Bujar Alimani. Pas filmit ka sesion pyetje & përgjigje. Jeni të ftuar me kënaqësi, por do ju lutesha konfirmim pasi vendet në kinema Millennium janë të limituara". Zëdhënësja merr konfirmimet nga gazetarët e kulturës dhe në vijim njofton për filma të tjerë në festival. Por parapremiera e "Delegacionit" u shndërrua në një skenë fyese për të ftuarit dhe familjarët e ekipit të filmit. Ardhja e kryeministrit në kinema trazoi ujrat. Në fillim me pretekstin se protokollit i shefit të qeverisë nuk lë të hyjë asnjë gazetar të paakredituar, më pas me pretekstin se nuk keni bileta, e më pas nuk keni ftesa, gazetarët e ftuar nuk u lanë të hyjnë në sallë. Askush nuk ishte në gjendje të shpjegonte saktësisht se çfarë po ndodhte. Vetë zëdhënësja e festivalit ngrinte duart lart me shpjegimin se edhe ajo sapo ishte vënë në djini dhe nuk kishte se çfarë zgjidhje të jepte. Megjithatë, gazetarëve u tha të presin se do të mund të bëhej diçka. Grupi i reporterëve u mblodh jashtë kur befas, në krah të tyre mbërrin i irrituar aktori Ndrçim Xhepa. As ai nuk ishte lënë të futej nga hostess e kinemasë, sepse nuk kishte biletë. Irritimi i Xhepës solli menjëherë jashtë Agron Domin organizator i festivalit dhe Ilir Butkën kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Të dy i kërkonin Xhepës të hynte në sallë, sepse interpreton në film që shfaqet, por ai tanimë i fyer refuzon. "Nuk hyj brenda se nuk kam biletë. E kam parë filmin tre herë, nuk dua ta shoh më. Do rri jashtë të pi një kafe". Ndërkaq, Ilir Butka dëgjohej të thoshte se ia kish dhënë biletën e tij kryeministrit, e Agron Domi, premtori t'i japë Xhepës, biletën e tij. Xhepa refuzon.

çdo gjë, dëgjojnë çdo gjë, madje edhe e xhirojnë skenën. Xhepa pranon të hyjë pas lutjeve, i kërkohet ndjesë dhe i thuhet "se nuk e njohën". Qesharake! Nuk njohën Ndrçim Xhepën.

Rrëfimi i një premiere në kinema, ku gazetarët e ftuar dhe vetë aktori i filmit, Ndrçim Xhepa u lanë jashtë



NDRÇIM XHEPA

Irritimi i Xhepës solli menjëherë jashtë Agron Domin organizator i festivalit dhe Ilir Butkën kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Të dy i kërkonin Xhepës të hynte në sallë, sepse interpreton në filmin që shfaqet, por ai tanimë i fyer refuzon. "Nuk hyj brenda se nuk kam biletë. E kam parë filmin tri herë, nuk dua ta shoh më. Do rri jashtë të pi një kafe". Ndërkaq, Ilir Butka dëgjohej të thoshte se ia kish dhënë biletën e tij kryeministrit, e Agron Domi, premtori t'i japë Xhepës, biletën e tij. Xhepa refuzon.



Gazetarët thërrasin Agron Domin për të ditur se çfarë do bëhet me ta, por ai nuk dëgjon. Vrapon brenda. Kryeministri ka hyrë, ministrja e Kulturës po ashtu, shfaqja duhet të nisë. Ç'rëndësi kanë gazetarët?! Pak minuta më vonë, dëgjohej duartroktitje. Ne jemi ende jashtë duke pritur që dikush të na sqarojë, se çfarë do bëhet me median. Asgjë. Pas duartroktitjeve, Genta Ramadani del dhe vjen pranë tyre. Kërkon ndjesë dhe ofron

keqardhjen e saj me shumë edukatë. Por gazetarët nuk kanë mbërritur në kinema për të gjetur aty keqardhje. Gazetarët thotë ajo, nuk mund të hyjnë gjithësesi. As ato që sigurojnë ftesa nuk lejohen më. Filmi vijon, teksa media ndalohej. Jemi para një situatë të turpshme dhe qesharake.

Pra, qeveria nuk jep fonde për festivalin, festivali del në media të ankohet, por kur shefi i qeverisë vendos të shfaqet në festival

KRYEMINISTRI

Ardhja e kryeministrit në kinema trazoi ujrat. Në fillim me pretekstin se protokollit i shefit të qeverisë nuk lë të hyjë asnjë gazetar të paakredituar, më pas me pretekstin se nuk keni bileta, e më pas nuk keni ftesa, gazetarët e ftuar nuk u lanë të hyjnë në sallë. Askush nuk ishte në gjendje të shpjegonte saktësisht se çfarë po ndodhte.

gazetarëve të ftuar, festivali (apo kush?! Sepse nuk morëm kurrë një përgjigje) u ndalon hyrjen duke ricikluar qasjen negative të vetë kryeministrit ndaj mediave.

Gazetarëve të akredituar, festivali nuk u kishte bërë gati badge. E nëse media është një entitet i madh, që shkon deri të pronarët dhe marrëdhëniet e tyre me qeverinë, festivali u ndaloj hyrjen gazetarëve të kulturës, që nuk janë më pjesë e një entiteti të madh (dhe kësaj pothuaj anonim) me dy raporte- janë gazetarë që drejtuesit e festivalit i njohin personalisht, emër për emër prej vitesh. Me gjasë, siç ndodh rëndom, fajti do hidhet degë më degë, nga 'protokollit' i kryeministrit të hostess-et e kinemasë që ndaluan dhe aktorin e filmit që shfaqet, Ndrçim Xhepa, mandej të produksioni i vetë filmit. E vërteta është që filmi shfaqet në një festival, zëdhënësja e të cilit prej së shtunës kishte kërkuar konfirmime për gazetarët që do ishin të pranishëm- për çka fajti i mbetet atij që fton e të mbyll derën duke ta përplasur surratit. Por po, ne kemi qeverinë që meritojmë, sepse lëmë jashtë Ndrçim Xhepën për të futur brenda shefin e qeverisë; dhe po ne kemi qeverinë e shtetit që meritojmë, sepse lëmë jashtë gazetarët për të futur kryeministrin pas të cilit vrapojmë.

Me gjasë ditë në vijim media e vetme që do e ndjekë TIFF do jetë "ertv", drejtuesi i së cilës mirëpret çdo ofertë të pakërkuar, si kjo e një festivali që bëhet shpurë e tij.

Çka përndryshe nuk do të përbente asnjë problem për t'u pajisur vetë me biletë secili gazetar nëse paraprakisht do i ishte thënë ta bënte. Por kur gazetarët ftohen për një film dhe sesion pyetje&përgjigje dhe konfirmojnë, për të lënë të lirë rradhën e tyre në kinema si besnikët e festivalit e si përcjellësit e lajmeve, ftesa dhe orët e humbura në oborin e betontë me duart e ngritura lart të zëdhënësës, janë kategoria ZH e një festivali filmi. Sepse kategoria përcaktohet jo veg prej filmave, por edhe prej këtyre raporteve me median dhe vetë imazhin e një festivali. Mendojnë pak që prania e Emanuel Makron në Kanë të lërë gazetarët jashtë. Tingëllon absurde. Po! Po! (E di që) TIFF nuk është Kana, Rama nuk është Makron, unë nuk punoj për 'Hollywood Reporter' dhe Shqipëria nuk është Franca- kjo që ndodhi të dielën e bëri më të qartë. Por ai kuartet i ç'harmonizuar më lart tregon qartë pse ne jemi këtu ku jemi e ata atje ku janë.



Opinion

i Ditës

Dialogu me Serbinë dhe nevoja për t'i mbajtur negociatat sekrete deri sa të arrihet marrëveshja

Nga Adri Nurellari

(vijon nga faqja 1)

... të dialogut, është pretendimi se ato nuk janë mjaftueshëm transparente për publikun. Është e vërtetë që transparenca është një ndër shtyllat kryesore të demokracisë dhe se mbajtja e publikut në errësirë delegjtimon proceset duke i bërë ato që të duken elitiste, aristokratike apo oligarkiste. Mirëpo po ashtu dihet se ka sektorë që prekin interesat shtetëror për të cilat sekretet është i domosdoshëm si siguria, inteligjenca, rendi apo edhe diplomacia. Kardinali Risheli, kryeministri i famshëm i Francës dikur thoshte se "Sekreti është shpirti i punëve të shtetit". Mungesa e informimit të publikut mbi diskutimet dhe prapaskenat e negociatave në Bruksel, jo vetëm që nuk është ndonjë shkelje, por është normë apo praktikë tipike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Prandaj, për hir të së vërtetës, duhet thënë që këto pretendime për transparençë negociatash ose burojnë nga një injorancë e thellë për mënyrën se si bëhen negociatat nëpër botë ose janë thjeshtë një maskë për të kamufluar kundërshtimin që ekziston ndaj dialogut në përgjithësi, e Thaçit, si kryenegociator, në veçanti.

Pikësëpari, duhet bërë një dallim, midis marrëveshjeve sekrete dhe negociatave sekrete. Sot ka një konsensus ndërkombëtar kundër traktateve sekrete mes shteteve. Ato ishin shumë të shpeshta në shekullin e 19-të, por janë shumë të rralla sot. Me ardhjen në pushtet të bolshevikëve, pas Revolucionit të Tetorit në nëntor 1917, Leon Trocki i bëri publike traktatet sekrete që çari kishte bërë me fuqitë e mëdha të aleancës së Antantës. Duke theksuar këtu Marrëveshjen e Kostandinopojës, e cila parashikonte ndarjen e Perandorisë Osmane mes Rusisë e vendeve të tjera partnere si dhe Paktin e Londrës që joshi italianët që të dilnin nga Blloku Trepalësh në këmbim të gllabërimit të një pjese të bregdetit shqiptar dhe dalmatin. Bëra publike e këtyre marrëveshjeve shkaktoi një indinjatë dhe siklet të madh anëmbanë botës duke fermentuar një klimë të përshatshme ndërkombëtare kundër marrëveshjeve ndërkombëtare të fshehta. Prandaj, jo rastësisht, pika e parë, në listën e 14 pikave të paragrafit në 1918 nga presidenti Wilson për të ndërtuar një rend të ri ndërkombëtar, ishte pikërisht pika për eliminimin e ujdiave sekrete në diplomaci.

Krejt e kundërta qëndron me negociatat sekrete, ku bisedimet janë sekrete, mirëpo rezultatit i tyre, pra marrëveshja finale është publike. Lidhur me negociatat ekziston një paradigmë e kon-



soliduar dhe e pranuar gjerësisht se është më mirë që ato të zhvillohen në mënyrë sekrete. Faktikisht, paprekshmëria e çantave dhe korrierëve diplomatikë, komunikimi me mesazhe të shifruara apo bisedimet e fshehta nën rrogaz janë pjesë thelbësore e diplomacisë e, madje, janë koduar në të drejtën ndërkombëtare. Mjafton të lexosh Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, për të kuptuar se ajo është konceptuar si një instrument që iu jep mundësi diplomatëve për ta mbrojtur e mbajtur informacionin e fshehtë prej shtetit pritis, prej shteteve të tjera e prej mbarë publikut. Po ashtu, ka shpesh raste ku jo vetëm që bisedimet mbahen sekrete, por që për hir të interesave shtetërore, publiku nuk e di fare që është duke u bërë një negociatë. Kur u morr vesh gatisshmëria e SHBA-ve për të bërë një marrëveshje paqe me Vietnamin Verior, Henry Kissinger i kishte bërë tashmë 12 runde takimesh sekrete me vietkongët dhe kinezët.

Përpos kësaj, duhet thënë se publiku i gjerë nuk ka as aftësinë as kohën për të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në debatin diplomatik që mund të ndizet si rezultat i bërjes publike të të gjitha informatave lidhur me negociatat. Negociatat për përmbylljen e fazës finale të dialogut me Serbinë janë tejet të ndërlikuar e vijnë pas 7 vitësh negociatash të vazhdueshme të koklavitura teknike. Për këtë arsye është goxha e vështirë që të pritët që qytetarët e thjeshtë të kenë njohurinë, ekspertizën apo informimin e plotë që nevojitet për të pasur një opin-

ion të pjekur dhe të duhur mbi një çështje si kjo. Kjo temë njëherazi ngjall shumë emocione dhimbje e marazi, të cilat e mjeçullojnë akoma më shumë mendimin e arsyeshmë.

Kur flitet për emocione, vlen të përmendet se më shumë se sa shqetësimi për transparençën, shumica e kundërshtarëve të dialogut thjesht i kanë ende sytë të errur nga instinkti i hakmarrjes e nuk ndihen gati për të kapërdirë një marrëveshje me armiqtë historikë. Shtetet serioze dhe burrështetasit nuk e kanë luksin të ngelen peng të vajtitimit e marazit, por duhet të kapërcejnë pengesat emocionale për hir të interesave shtetërore. Rasti më ekstrem që e dëshmon këtë gjë nëpër botë është negociimi me aktorët jokonvencionalë apo jostetërorë sikurse janë terroristët.

Në parim shtetet demokratike deklarohen se refuzojnë të negociojnë me terroristët sepse nuk duan të bëhen peng të dhunës dhe nuk duan që të shpërblehen që shkaktojnë dhunën. Pranimi i terroristëve në tryezë të bisedimeve në njëfarë mënyre i amneston apo i legjitimon aktet e tyre të dhunshme dhe ndërkohë dekurajon ata aktorë dhe faktorë që përpiqen të arrijnë qëllimet e tyre politike me mjete paqësore. Megjithatë, në realitet, në praktikë, qeverive demokratike më të avancuara, shpesh iu duhet që të negociojnë me terroristët. Kështu për shembull qeveria spanjolle u ul në bisedime me terroristët baskë të ETA-s vetëm gjashtë muaj pasi ky grup kishte vrasë 21 qytetarë në 19 qershor 1987, nëpërmjet një makine bombe të vendosur në supermar-

katën Hipercor në Barcelonë. Izraeli, që është i njohur dorën e ashpër me të cilën e trajton terrorizmin, negocioi në mënyrë të fshehtë marrëveshjet e Oslos në vitin 1993 në një kohë kur Organizata për Çlirimin e Palestinës vazhdon të aktivitetet e saj terroristë dhe refuzonte që të njihte të drejtën e shtetit të Izraelit për të ekzistuar. Britanikët e mbajtën një urë komunikimi me terroristët e IRA-as edhe në vitin 1991 kur kjo organizatë pothuaj shfarosi të gjithë kabinetin qeveritar të Britanisë nëpërmjet një sulmi me mortaje. Po ashtu në vitet e fundit është bërë publike se ka pasur bisedime intensive sekrete të amerikanëve me talebanët.

Gjithsesi, rasti i dialogut me Serbinë nuk është aspekt ekstrem sikurse janë negociatat sekrete me terroristët, por është një rast relativisht i zakonshëm e i përhapur, sepse sot pothuaj një e treta e shteteve të botës janë shtete që po tranzitojnë drejt demokracisë pasi kanë dalë nga një konflikt ndër-shtetëror apo luftë civile. Pra, ka një praktikë goxha të konsoliduar të mbajtjes së negociatave sekrete për t'iu vënë kapak konflikteve të së kaluarës. Sekretet në negociatë është i nevojshëm goftë përkundrejt palës tjetër e goftë përkundrejt opinionit publik të brendshëm. Ashtu sikurse një trajner nuk bën publike të gjitha skemat dhe strategjitë e parashikuara para një ndeshjeje futboll, sepse kjo gjë i jep mundësi kundërshtarit që t'iu paraprijë e t'iu gjejë një kundërshtues qëndrueshëm një makine bombe të vendosur në supermar-

fidencialitet të plotë. Të kërkoesh nga negociatori që të negociojë me transparençë të plotë është njësoj sikur të kërkoesh nga një lojtar pokeri që të luajë me letrat që ka në dorë zbuluar para kundërshtarit. Hapja e materialeve të negociatave do zbulonte ndjeshmëritë dhe rrethanat e tjera delikate të Kosovës duke e vënë palën tonë në pozicion inferior ndaj Serbisë, por edhe ndaj shteteve të tjera.

Për ta kuptuar se sa i hershëm është ky tension midis transparençës përbën një shtyllë demokracisë dhe nevojës për konfidencialitet në negociatë, mjafton të lexohet mesazhi i Xhorxh Uashington për Kongresin në mars të vitit 1796, kur ai refuzoi që të bënte publike udhëzimet dhe dokumentet e përdorura në negociatat me mbretin Xhorxh III. "Natyra e negociatave të huaja kërkon kujdes, dhe sukseset e tyre shpesh duhet të varet nga sekretet; madje edhe kur të nxirret përfundimi, një zbulim i plotë i të gjitha masave, kërkesave apo koncesioneve eventuale që mund të jenë propozuar ose parashikuar do të ishte gjë jashtëzakonisht e pamatur, sepse kjo mund të shkaktojë një ndikim të dëmshëm në negociatat e ardhshme ose të krijojë vështirësi të menjëhershme, ndoshta rrezik dhe rrëgjellime, në lidhje me fuqitë e tjera".

Mirëpo negociatat janë të nevojshme që të mbahen të fshehura jo vetëm ndaj vendeve të tjera, por edhe ndaj opinionit publik të vendit të vetë negociatorit. Negociatat çojnë drejt një kompromisi të dyanshëm që kërkon që të dy palët të fokusohen në interesa e tyre e jo në qëndrimet e deklaruara. Po ashtu kuptohet që duhet lëshuar diku për hir të bindur palët tjetër që të ketë interes tek negociatat dhe rezultatit i tyre. Asnjë negociator nuk do të donte që të merrte vesh paraprakisht se çfarë lëshimesh apo tolerimesh është i gatshëm të bëjë pa u siguruar që ka marrë së paku një gjë ngjashmërisht të vlefshme në këmbim. Pra, negociatorët, që ta bëjnë punën, siç duhet të jenë të siguruar, se ata do të vlerësohen e gjykojnë për rezultatit përfundimtar të bisedimeve e jo për procesin. Nëse procesi do të ishte objektivi kryesor e jo ujdja finale, atëherë kuptohet që negociatorët do të fokusoheshin më shumë te procesi sesa tek arritja e një marrëveshjeje. Mirëpo të gjithë e dimë që për negociatorët dhe për mbarë shoqërinë, interesi kryesor është rezultati, pra ujdja e realizuar e jo mënyra se si e arrin.

Është e kotë të paragjykoesh duke u thirrur në transparençë, sepse me nuk e dimë se çfarë ka brenda një marrëveshjeje derisa ajo të përfundojë. Kjo nevojë publike legjitime për transparençë do të shterohet pas arritjes të saj, sepse do të ketë kohë të mjaftueshme pas përfundimit të



Opinion i Ditës

Dashnorët e rremë të Kushtetutës

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... Ramës kandidaturën për ministër të Brendshëm.

Ai nuk ka ndjekur as trashëgiminë e paraardhësve të tij, që nuk kanë guxuar ta hedhin këtë hap dhe as shembujt më të mirë të presidencës së vet, kur ka shpjeguar me detaje aktet e forta që ka ndërmarë.

Por këto pikëpyetje, që e bëjnë edhe më të mistershme "djegjen" e Sandër Lleshit, sado të errëta qofshin, nuk e justifikojnë aspak kryqëzatën e ndryrë që të gjithë mbështetësit e Rilindjes kanë nisur kundër presidentit.

Sepse, po të shihet me kujdes, i gjithë mllafi i tyre buron nga një premisë: nga dashuria e tyre për ligjin themeltar të shtetit, i cili po u përdhoska nga presidenti që përfiton nga fakti se vendi gjendet pa Gjykatë Kushtetuese.

Duhet thënë që në fillim, se dashnorët e rinj të Kushtetutës, nuk flasin si konstitucionalistë, por thjeshtë si ramistë. Sepse po të ishin të merakosur për të parën, ata do ta kishin ngritur zërin me kohë. Ata do të kishin folur kur çorba speciale e grabitjes Rama- Fusha u miratua në parlament, ata do të kishin reaguar kur ligjet kundër ish-pronarëve ndryshuan sipas orekëve të pushtetit, ata do të kishin ngritur zërin kur marrëveshja e detit me Greqinë përparononte në fshehtësi nga publiku.

Të gjitha këto kanë ndodhur në mungesë të një Gjykate Kushtetuese dhe askush nga kritikët e sotëm të Ilir Metës nuk është ndërjerë. Sepse atyre nuk u intereson ligji, por idhulli i tyre i paprekshëm.

Në fakt, i gjithë ky debat, që mund të zhvillohet vetëm nga një grusht i vogël juristësh të kualifikuar, i ngjan në thelb një diskutimi tejet më banal, që po gëllton në të njëjtat mjedisë. Ato njëzëri po i referohen pjesëve nga libri KURBAN, ku Rama e përshkruan vëllain e tij armik të së matjës, si një paranojak të çekuilib-



ruar. Pra edhe këtu, ata e shohin fajin te Meta, që në rastin e mosdekremit po silltet fiks ashtu sikurse kryerilindasi e kishte portretizuar në vitin e largët 2011.

Kulmi i mungesës së sinqeritetit.

Sepse po t'i kishin besuar vërtet atyre që kanë lexuar në sibiblën e tyre KURBAN, së paku do t'i kërkonin llogari, Edi

Ramës, kur vendosi të bëjë qeveri me Ilir Metën në 2013, apo do ta bënin copë e çikë kur vendosi ta bëjë kryetar shteti në 2017.

Atëherë heshtën. Prandaj sot, sa herë që flasin, nuk e bëjnë nga besimi, por nga nevoja dhe nga hidhërimi.

Prandaj, nëse duam të diskutojmë për precedentin e fortë që ka vendosur presidenti, nëse duam të kuptojmë zërat pro dhe kundër tij, nëse mëtojmë të gjejmë arsyet e drejta apo të errëta të Ilir Metës, së pari, duhet të bëjmë dy gjëra.

Fillimisht duhet të heqim mënjënjë dallëshmëri që bëjnë zhurmë për llogari të Edi Ramës. Dhe pastaj duhet të kërkojmë ringritjen e një Gjykate Kushtetuese, mungesa e së cilës nuk i shërbeu vetëm mëkateve të pafundme të kryeministrit. Ajo mund t'u përdorka njësoj edhe nga kundërshtarët e tij.

Lapsi.al

Duhet thënë që në fillim, se dashnorët e rinj të Kushtetutës, nuk flasin si konstitucionalistë, por thjeshtë si ramistë. Sepse po të ishin të merakosur për të parën, ata do ta kishin ngritur zërin me kohë. Ata do të kishin folur kur çorba speciale e grabitjes Rama- Fusha u miratua në parlament, ata do të kishin reaguar kur ligjet kundër ish-pronarëve ndryshuan sipas orekëve të pushtetit, ata do të kishin ngritur zërin kur marrëveshja e detit me Greqinë përparononte në fshehtësi nga publiku.

negociatave për të debatuar dhe ratifikuar paketën e udhës së arritur. Pra, me rëndësi të madhe është transparenca e plotë e udhës së arritur e jo veprimet e ndërmarra për ta arritur atë. Paragjykimet në vetvete janë shpesh pengesa të mëdha për të arritur marrëveshje paqeje. Në mungesë të bisedimeve, negociatorët nuk e dinë a është e arritshme apo jo një marrëveshje nga e cila përfitojnë të dy palët. Po ashtu nuk e dinë se cili propozim për marrëveshje do të marrë mbështetjen e duhur nga parlamenti e cili propozim do të bllokohet. Negociatat janë në mënyrë të pashmangshme ekuacione me shumë të panjohura dhe, nëse shtetet e ndryshme do të prisnin deri sa të kishin informacionet të plotë mbi të gjitha elementet e një konfliktit apo mosmarrëveshjeje, gjasat janë të mëdha që nuk do të zhvilloheshin

ndonjëherë negociata për çështje komplekse si çështja jonë.

Duhet kuptuar se bisedimet sekrete iu ndihmuan diplomatëve që të jenë të lirë dhe të sinqertë në shprehjen e pikëpamjeve të tyre duke mundësuar ndërtimin e një raportit mirëbesimi dhe kanali të pranueshëm komunikimi me palën tjetër. Diplomacia e hapur e transparente tingëllon dinjitoze në teori, por mund të jetë mashtruese në praktikë. Kjo sepse nevoja për të siguruar simpatinë publike për një çështje të rëndësishme shtetërore, mund të bëjë që diplomatët të shtiren, të praktikojnë propagandë apo makijazhe të pëlqeshme për masat por që shkojnë ndesh me interesin e vendit.

Për ta kuptuar më mirë nevojën për aktrim para publikut të diplomatëve apo negociatorëve, mjafton të shikohet situata me elitën politike shqiptare dhe sjelljen në

parlament. Në seancat me dyer të hapura që transmetohen nga televizioni, deputetët nuk komunikojnë më natyrshëm me njeri tjetrin, por me audiencën publike, duke e shfrytëzuar situatën për të bërë elektoratin për vetë. Pra, aktrorët duke u hequr si pasionantë, duke simuluar apo provokuar përplasje, mbajtur tonet të ndezura e agresive ndaj kundërshtarëve publikë. Në privat, jashtë kamerave, ata janë shumë më tepër konstruktiv e bashkëpunues, janë shumë më tepër të gatshëm për dialog, ndërveprim e mirëkuptim. Për këtë arsye, edhe pse mund të duket ironike, gjasat janë që puna e parlamentit të jetë më konstruktive nëse nuk ka kamera e bashkë me to, nevojë për aktrim.

Janë të shumta proceset e negociatave të paqes nëpër botë që, sikurse po ndodh në Kosovë, janë penguar nga inate e hatërmbetje

personale; janë bllokuar nga tendenca ekzibicioniste të shumë personave që kanë qëndrime e retorikë populiste për t'u bërë më popullore; apo janë ndalur nga politikanë të papërgjegjshëm që i hedhin benzinë emocioneve të urrejtes, hakmarrjes e frikës për të marrë më shumë vota. Status quoja ka një inerci të sajën që do shumë fuqi e energji për ta përbalbur e për ta ndryshuar. Arritja e paqes dhe mbyllja e kapitullit të konfliktit, kërkon një sens të lartë përgjegjësie dhe detyrë dhe kërkon liderë kurajozë, të gatshëm të sakrifkohen për popullaritetin e tyre për hir të interesave shtetërorë. Fundja dihet mirë që dallimi kryesor mes politikanëve kalimtarë dhe burrështetasve historik është se politikanët mendojnë vetëm për zgjedhjet e ardhshme ndërsa burrështetasit për brezat e ardhshëm.

HOROSKOPI

DASHI

Do të ndihen të mbushur plot energji dhe do t'ju rritet besimi në vetvete. Përdorni idetë e reja për të fituar më shumë para. Fëmijët do t'ju bëjnë të ndihen krenarë me arritjet e tyre. Sa i përket marrëdhënies romantike, do të përballemi me disa probleme.

DEMI

Personat e kësaj shenje që vuajnë nga tensioni duhet të bëjnë shumë kujdes për shëndetin, mbi të gjitha nëpër hapësirat e shumë populluara. Nuk do të keni shumë durim sot, kështu që mbani veten nën kontroll pasi mund të ofendoni njerëzit përreth jush.

BINJAKET

Emocionimi i tepërt dhe pasioni i zjarrt mund të ndikojnë negativisht në sistemin tuaj nervor. Përpunoni t'u përshatani nevojave familjare. Bashkëshorti/bashkëshortja juaj mund të ndihen të parëndësishëm krahas jush sot, për shkak të axhendës suaj të ngarkuar.

GAFORJA

Do të bënit mirë të ushtronit disa aktivitete sportive. Bëni kujdes me transaksionet financiare. Ka gjasa që sot të merrni një dhuratë shumë të veçantë. Romanca do t'ju udhëheqë zëmren. Bashkë me partnerin/partneren do të kujtoni kohët e vjetra.

LUANI

Do të ndihen mirë nga ana shëndetësore, pavarësisht axhendës suaj të ngarkuar. Mos investoni në skema të dyshimta financiare. Ka gjasa të përballemi me një incident sot. Do të realizoni një bisedë të këndshme me partnerin/partnerin tuaj.

VIRGJERESHA

Edhe pse do të kaloni një ditë të lodhshme, energjia në fund të ditës nuk do t'ju mungojë. Do të fitoni mjaftueshëm para, por mija e shpenzimeve nuk do t'ju lejojë të kurseni. Sot do të jetë një nga ato ditë, kur gjërat nuk do të ecin ashtu siç duhet.

PESHORJA

Një ndër pikat tuaja kryesore është sensi i humorit. Përdoroni atë për t'u gëlltur nga stresi. Ka gjasa të anuloni një prej planeve tuaja për shkak të një ndryshimi momentim e fundit në axhendën tuaj. Sa i përket jetës martesore, do të kaloni disa çaste për t'u mos harruar.

AKREPI

Do të përballemi me një problem, por të cilin miqtë do t'ju vijnë në ndihmë. Muzika e "dashurisë" është në sfond, për të gjithë personat e kësaj shenje që janë pranë përjetimit të një ndjesie të tillë. Sa i përket çifteve të martuar, do të debatojnë për disa çështje të parëndësishme.

SHIGJETARI

Do të keni kohë mjaftueshëm për t'u relaksuar. Ka gjasa që të shpenzoni shumë për shkak të pagesës së faturave. Ju dhe partneri juaj keni nevojë për më shumë hapësirë.

BRICJAPI

Largoni "errësirën" që po zhvillohet tek ju ditë pas dite, duke shkatërruar progresin. Ka gjasa të arrini një marrëveshje të re financiare, e cila do t'ju sjellë të ardhura. Tregoni pjekuri në marrëdhënien tuaj romantike.

UJORI

Sot do të ndihen të relaksuar dhe në gjendjen e duhur për t'u argëtuar. Do të keni dëshirë të bëni sa më shumë blerje, por mund të pendojeni më pas. Sot mund të përjetoni diçka shumë të pazakontë në marrëdhënien tuaj romantike.

PESHQIT

Problemet personale mund t'ju ndikojnë në gjendjen psikologjike. Disa fatura të paplurra mund t'ju rrisin bonhin. Ka gjasa të shtyni një udhëtim, për shkak të shëndetit të një anëtarit të familjes. Shmangni personat që qëndrojnë krahnë jush vetëm për interes.



FSHF ndreq një tjetër gabim, nuk mbyll më stadiumin

Federata nuk dënon "Selman Stërmasin", por vetëm grupimin "Fanatiks"

Parulla kundër Refik Halilit, që solli vonesë në fillimin e ndeshjes kundër Teutës i ka kushtuar shtrenjtë grupimit "Tirana Fanatics". FSHF-ja ka vendosur të dënojë grupimin bardheblu dhe Komisioni i Disiplinës kërkon që Tirana duhet të mbyllë sektorin përkatës të stadiumit për këtë

grupim në dy ndeshjet e radhës, ndërsa kushdo tjetër që nuk përfaqëson grupimin pritet të lejohet normalisht të ndjekë ndeshjen në tribuna. Ky është rasti i parë ku Disiplina vendos të mos japë një dënim kolektiv për sjelljen e tifozëve në stadium. Normalisht, KDS jepte vendime duke

mbyllur stadiumin e përgjithësuar si të njëjtë të gjithë tifozët, si ata problematikë, ashtu edhe ata që shkonin për të ndjekur ndeshjen pa shkakuar rrëmujë. Ndaj vendimi për të lënë jashtë vetëm "Tirana Fanatics" krijon precedentin e parë të një vendimi që nuk është kolektiv e

që mund të shërbejë për ngjarje të ngjashme në të ardhmen. "Grupimi i Tifozëve të KF Tirana", 'Tirana Fanatics' për sjellje të gabuar duke paraqitur parulla ofenduese, në bazë të nenit 21 dhe 66/3 të KDS përjashtohet nga pjesëmarrja për 2 (dy) ndeshje të njëpasnjëshme në sektorët përkatës të stadiumeve urdhërohet KF 'Tirana', të ekzekutojë vendimin duke mbyllur sektorët përkatës", lexohet në njoftimin e FSHF-së.

Flamurtari, Kukësi e Partizani nuk pranuan ndryshimin e kalendarit në favor të kampionëve



Jeton Selimi

Presioni i klubeve, Federata Shqiptare e Futbollit bën prapaktheu Laçi-Skënderbeu do të luhet sipas programit

Federata tërhiqet nga vendimi i saj absurd për të spostuar takimin Laçi-Skënderbeu në një ditë tjetër me pretekstin se skuadra e Laçit nuk ka mundur të gjejë fushë për të organizuar zhvillimin e këtij takimi, pasi në stadiumin e skuadrës nga Kurbini po kryhen procese të rinovimit të barit. Por, vendimi i FSHF-së ka bërë të reagojnë të gjithë pretendentët, të cilët nuk kanë mundur të pranojnë këtë ndryshim date. I pari ka reaguar presidenti i Flamurtarit, Shpëtim Idrizi, që në një prononcim për "Panorama Sport" ditën e djeshme sulmoi hapur FSHF-në, e cila po ndikon garën. "Nëse nuk luajnë Laçi dhe Skënderbeu, pasi prishet gara dhe është hap-tazi favorizim. Kjo nuk ka logjikë. Rregullorja është shumë e qartë. Atëherë të shtyhet për të gjithë dhe të mos luhet këtë të mërkurë, ose u japim ne fushën tonë dhe të shtymë ndeshjen tonë me Luftëtarin", tha Idrizi. Por më vonë, edhe presidentët e tjerë të



skuadrave pretendente, Safet Gjici e Gazmend Demi kanë thënë fjalën e tyre. Për presidentin e Kukësit, zhvendosja e datës nuk është aspak nor-

male, ndonëse ai nuk mendon se kjo bëhet për të favorizuar njërin apo tjetrin ekip. "Vendimet janë të federatës, por gara është garë dhe mirë do të ishte mos të

SUPERLIGA		
JAVA E 12-të		
TE MARTËN		
Tirana - Kukësi		18:00
TE MERKURËN		
Kastrioti - Partizani		14:00
Kamza - Teuta		14:00
Laçi - Skënderbeu		14:00
Flamurtari - Luftëtari		17:00
RENDITJA	N	P
Skënderbeu	11	26
Partizani	11	25
Kukësi	11	19
Laçi	11	19
Flamurtari	11	18
Teuta	11	18
Tirana	11	9
Luftëtari	11	9
Kamza	11	8
Kastrioti	11	4

shtyhej. As ne nuk kemi stadiume dhe është problem i madh, por duhet gjetur mundësi tjetër për ta zgjidhur, por ky vendim nuk besoj se ka qëllim për të favorizuar Laçin ose Ko-

rcën", deklaroi Safet Gjici. Ndërsa për presidentin e Partizanit, Gaz Demi, kjo është një gafë e papranueshme, pasi edhe justifikimi është i habitshëm, pasi të gjitha skuadrat kanë probleme me fushat. "Nuk e besoj një gjë të tillë. Nuk besoj se administrata e FSHF-së të jetë kaq e painformuar nga rregullorja dhe të prishë garën. Nëse është e vërtetë që Laçi ka probleme për të gjetur fushë, le të shtyhet e gjithë kjo javë. Të gjithë kemi probleme me fushat. Megjë e ka Laçi këtë problem, i bëjmë nder neve federatës dhe pranojmë që të shtyhet e gjithë java", deklaroi presidenti i kuq. I gjendur nën presionin e kolegëve të tij, edhe presidenti Takaj ka kërkuar që ndeshja të zhvillohet sipas

programit të paracaktuar. "Ne jemi të interesuar ta luajmë ndeshjen. Ekipi është gati, ka lënë Korçën dhe është në kompleksin "Tropikal" në Durrës. Po presim njoftimin nga federata për atë që do të bëhet, por jemi gati që të luajmë. Ne nuk na intereson shtyrja e ndeshjes për vetë momentin që po kalon ekipi", deklaroi Ardjan Takaj. E mbërthyer në morsën e presidentëve të klubeve kryesore të Superligës, Federata Shqiptare e Futbollit ka bërë prapaktheu duke dalë me një komunikatë zyrtare pasditën e djeshme, ku njoftohej zhvillimi i takimit Laçi-Skënderbeu sipas kalendarit. "Sektori i Garave pranë Federatës Shqiptare të Futbollit njofton median dhe opinionin futboll-dashës se ndeshja Laçi-Skënderbeu do të zhvillohet ditën e mërkurë në kryeqytet, në stadiumin "Selman Stërmasi" ora 14:00. Përballja Laçi-Skënderbeu, e vlefshme për javën e 12-të të Kategorisë Superiore do të zhvillohet në datën 7 nëntor", shkruhej në njoftimin e ardhur nga federata. Në fakt, kjo nuk është hera e parë që Skënderbeu përfshihet në kapërcime të tilla. Sezonin e shkuar, një marrëveshje me Villaznisë dhe Skënderbeut solli kapërcimin e kalendarit, duke ndryshuar fushat respektive në ndryshim me kalendarin fillestar, ku ndeshja e javës së nëntë, e parashikuar të luhej në Shkodër, u zhvillua në Korçë dhe ajo e javës së 18-të, e parashikuar të luhej në Korçë, u zhvillua në Shkodër.

Trajneri i Interit, Luciano Spaleti paralajmëron se duhet dhënë 100 për qind për të mposhtur Barcelonën, por e sheh ndeshjen e nesërme si një mundësi të mirë për ekipin e tij. Zikaltrit pothuajse mund të sigurojnë kualifikimin për 1/16-tën me një fitore sot dhe pas konferencës së shtypit të tij para ndeshjes, Spaleti ka folur rreth ndeshjes. "Ata janë më të mirët. Kjo është ndeshja më e vështirë dhe ne kemi një mundësi për të treguar se me të vërtetë mund të konkurrojmë me këdo. Në ndeshjet pas Barcelonës ne kemi dashur të forcojmë konceptin e mbajtjes së topit dhe pozicionimin në gjysmën e kundërshtarit. Duam të qëndrojmë sa më larg që është e mundur nga zona jonë dhe për të bërë këtë na duhet të luajmë si ekip. Duhet të jemi të mirë në sigurimin që kundërshtarët tanë nuk kanë kohë për të luajtur, duke i dhënë pre-

Champions, kryendeshja e mbrëmjes Spaleti: Barça më e forta, por duhet të tregojmë veten



sion të vazhdueshëm ku të gjithë lojtarët ndjekin topin", - ka thënë Spaleti.

CHAMPIONS LEAGUE		
GRUPI A		
Monako - Klub Bryzh		18:55
Aletiko Madrid - Borussia		21:00
GRUPI B		
Inter - Barcelona		21:00
Tottenham - PSV		21:00
GRUPI C		
Crvena Zvezda - Liverpool		18:55
Napoli - Paris Sën Zhërmen		21:00
GRUPI D		
Porto - Lokomotiv Moskë		21:00
Shalke 04 - Gallatara		21:00


Avioni po ulej, por pista ishte e zënë

Borussia e Dortmundit shpëton paq, piloti shmang tragjedinë

Udhëtimi i Borussia Dortmund drejt kryeqytetit spanjoll, Madridit nuk ka shkuar shumë mirë. Para ndeshjes kundër Atletikos ka pasur të "dridhura" nga lojtarët, për shkak të një incidenti. Kur ishte gati të ulej, në orën 13:00, piloti i avionit të skuadrës gjermane pa që në pistë ishte një avion tjetër dhe për të shmangur përplasjen, çka do të ishte tragjike, vendosi të ngrihet me urgjencë në ajër, duke fluturuar edhe gjysmë ore rreth Madridit. Në orën 13:29, afërsisht gjysmë ore me vonesë, avioni i Borussia Dortmundit është ulur i sigurt në kryeqytetin spanjoll. Këtë herë me një pistë të lirë.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Niven që qe aktor.
5. Little... kryeqyteti i Arkansas.
7. Janë tek në lakër.
10. Nuk ka akoma një bebe.
11. Kufizojnë katete.
12. Penn aktor.
13. Hector që shkroi Pa familje.
15. Thahen me bonifikime.
18. Mbyllin takimin.
19. Ndërmarrje Industriale Mat.
21. Mbyllen me epilog.
23. Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
25. Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
27. Njëlljo për latinët.
30. Eshhtë vend si Katari.
31. Pupi regjisor.
32. Janë strehat e çobanëve.
33. Eshhtë centrali si Chernobyl.
35. Fillojnë një argument.
36. Të parat në stadium

37. Mund të sjellin shi.
38. Kështu fillon Odisea.
39. Një mund të jetë emërORE.
42. Thirrje edhe kështu Persefoni.
44. Ai dhe ajo.
45. E ka lënë atë që s'ka fuqi
48. Para es Salaam.
49. Ylli i Londrës.
50. Eshhtë syzë... në komo.

VERTIKALI

1. Hyskja aktor.
2. Kush e thotë lutet.
3. Një tis mjegulle.
4. Maiden që këndojnë.
5. Gjysmë rekord.
6. Antonio skulptor i famshëm.
7. David regjisor.
8. Janë brijnë në skuadër.
9. Ruan në kufij.
12. Mban mikrofonin.
14. Janë edhe ato të fytyrës.
16. Qureshin edhe Eumenide.
17. Demek pa kufij.
20. Mund të jetë atomike.
22. Qyteti i përjetshëm.
24. Kitara e Ravi Shankar.
25. Janë katrore në sipërfaqe.
26. Një fjalë si gjoja.
28. Pak daktilografi
29. Eshhtë si divan.
31. Një pjesv e amerikanëve.
32. Bernhardt që qe aktore.
34. Eshhtë infeksion në veshë.
38. Një mund të jetë unik
40. Gjysma e sasisë.
41. Pak marramendëse.
43. Eshhtë dhomë.
45. Fillojnë takimin.
46. Në fund majtas.
47. Të fundit në manastir.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. E bardhë ajo Moby Dick.
5. Fillojnë amplifikimin.
7. Eshhtë vit që parashikohet.
10. Mbyllin pamjen.
11. U printe jeniçerëve.
13. Thurman aktore.
14. Një reaksion në provëz.
16. Një sport me brez të zi.
19. Në fund të fundit.
20. Janë në gjyq.
23. I është hequr të dënuarit.
24. Eshhtë shahu i fundit
25. Janë fletë trëndafil.
27. Kufizojnë një metër.
28. Tregojnë pallate në miniaturë.
29. Një fjalë pa shkak.
30. Janë përllogaritje.
32. Mbyllin një dritare.
33. Të parat në muzg.
34. Me të nxjerrin një letër.

VERTIKALI


35. Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
37. Toromani balerinë.
39. Iniciale e Reitman regjisor.
40. Fillojnë politikën.
42. Një piktor si Antonio Ligabue.
44. Diftong në dietë.
46. Një lind në kokë.
48. Kush ka... do të pijë.
49. Punojnë në galeri.
52. Fillojnë titrat.
53. Mund të jetë ekspres.
54. Mund të skadojë.
7. Nuk i bihet me kokë.
8. Sharif aktor.
9. Janë organet e taksave.
12. Me Haensel në përrallat e vëllezërve Grimm.
15. Vihen për të mbyllur.
17. Janë vegla.
18. Eshhtë medalja e të parit.
21. I dhimbset trikakakut.
22. Mund të jetë mbi xhiro.
26. Eshhtë liltar.
28. Janë inate të akumuluar
30. Eshhtë vëllia i gruas.
31. Një tip për të këcyer.
33. Edoard piktor.
36. Lumë në Francë.
38. Janë djemtë e... nënës.
41. Lindi Akilin.
43. Kodi i Celularit.
45. Mbledh basketë separatistë
47. Një është edhe Egjeu.
49. Fillojnë një metodë.
50. Dy anët e një neni.
51. Fillojnë ofensivën.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

7			8	4	1		5
9			5	2		8	3
5		2					
6				8	4		7
	3			7			
	4		1			6	
	7			6	1	5	4
1							8
	2	8	3	5			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	2	1	5	3	8	6	7	9
8	9	3	4	6	7	1	2	5
5	6	7	9	1	2	8	3	4
6	3	2	1	8	9	4	5	7
7	1	5	2	4	3	9	6	8
9	4	8	7	5	6	2	1	3
2	5	6	8	7	4	3	9	1
3	7	4	6	9	1	5	8	2
1	8	9	3	2	5	7	4	6

Argëtim filozofik

- Për ta gjetur vetveten, mendoni për vetveten.
- Fitimi i emrit përketheh në përpjekjet për të qenë çka dëshiron.
- Gjithë shpirtat e njerëzve janë të pavdekshëm, por shpirtat e të drejtëve janë edhe të pavdekshëm, edhe hjnorë.
- Lëviz vetë, përpara se të lëvizësh botën.
- Për sa i përket martesës ose beqarisë, vendos vetë, o njeri, por ta dish mirë se ke për t'u penduar.
- Martohu, patjetër. Por të ra gruaja e mirë, do të jesh i lumtur, po të ra e keqe, do të bëhesh filozof.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

2	11		2	11	1		7	1	13	4	1	3
4	6	2	15	1	3	6		4	1	3	6	
5	2	7		8		7	2	11	1	8	1	3
	17	1	13	6	12	9	5	1		3	5	
17			1	7	9	13	9	12	6	2		4
5	2		8	9	7	1	12	1	3		11	1
2	13	3	1	13	2		2	3	2	2	2	15
13	2	13	3	1	16	3		8	2	5	2	
7	13	1			6		6	8	6	5	1	3
	6		15	2	13	2	7		2	1	7	
15	2	5	8	1	3		13	1	4			
1		15	2	16	3	6		2	17	2	3	6

- Çlirimi i energjisë atomike nuk ka krijuar një problem të ri. Ka bërë më urgjente nevojën për të zgjidhur një ekzistues.
- Nëse jeni në botë të përshkruani të vërtetën, lërtani elegancën roboqepësit.

Thënie të mençura

- E vetmja gjë që bie ndesh me diturinë time është arsimimi.
- Për sa i përket përputhjes së ligjeve të matematikës me realitetin, ato nuk janë të sigurta; për sa i përket sigurisë së tyre, ato nuk përputhen me realitetin.
- Logjika praktike është mbledhja e paragjykimëve të përfuturuar në moshën 18-vjeçare.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

S	E	V	E	N	U	P	S	T	E	F	F	I		
A	M	I	N	K	A	P	I	T	A	L	I			
R	I	T	E	T	R	E	L		A	M				
A	L	E	T		F	I	L	O	K	T	E	T		
H	E		K	A	M	I	K	A	Z	E	K			
			P	R	O	T	O	K	O	L	L	A	R	E
K	A	T	A	M	A	R	A	N	I		O	T		
I	R		C	O	L	I	N		R	O	M	Y		
T	E	M	A	E	I	B	O	R	I	S				
A	N	I	T	A		A	M	I	L	A	N	O		
R	A	N	V	I	T	M	J	E	R	A	N			
E	T	I	L	E	N	F	R	A	T	I				
B	A	O	B	A	B	P	E	D	A	N	A	T		
R	P	E	R	I	P	A	T	E	T	I	K	E		
A	P	E	L	R	I	V	B	N	A	R				
V	E	L	P	T	R	A	M	I	D	A	M			
A	R	K	O	L	O	R	I	T	I	L	E			
P	R	O	T	A	G	O	N	I	S	T	E	T		
K	A	N	T	A	T	A	K	A	T					
A	R	I	E	L	A	T	A	K	U	R	E	T		
S	A	N	L	A	T	I	K	U	R	E	S			
P	I	R	E	S	I	P	I	R	A	T	I			
I	R	E	M	I	B	A	N	O	R	E	T			
K	R	A	T	E	R	E	T	G	J	I	R	I		

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

